

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5785  
E premte, 24 maj 2019  
çmimi 0.40 €

## Plani për tranzicionin e FSK-së do të implementohet në tri faza



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### OPINION

#### QËLLIMI DHE MËNYRA E KRYERJES SË KRIMIT: GJENOCIDI DHE MASAKRA

Shkruan:  
Bardhyl  
MAHMUTI



### AKTUALE

#### PROKURORIA KËRKON ZGJATJEN E PARABURGIMIT PËR GRATË E KTHYERA NGA SIRIA NË KOSOVË



#### NË KIRURGINË TORAKALE OPEROHEH 50 PACIENTË ME PAJISJEN BASHKËKOHORE



### EKONOMI

#### NGA TAKSA 100 PËR QIND, SERBIA HUMBI RRETH 300 MILIONË EURO

#### LLUKA: ENERGJIA E PASTËR DO TË JETË GJENERUESJA KRYESORE E VENDEVE TË PUNËS

### SPORT

#### FERONIKELI KËRKON EDHE KUPËN

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISMET KRYEZIU

## Samiti i Parisit do të jetë një pikë kthese për vazhdimin e dialogut

Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) ka vlerësuar se takimi i kryeministrit Haradinaj me kancelaren Merkel do t'i shërbejë Kosovës për ta adresuar agjendën e integritimit evropian dhe liberalizimin e vizave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se Samiti i Parisit do të jetë një pikë kthese nga dy shtetet për t'iu rikthyer tryezës së dialogut përmes së cilës do të synohet potencialisht arritja e një marrëveshje. Duke folur për zhvillimet në vend, Kryeziu ka thënë se LDK-ja dhe Vetëvendosja po synojnë krijimin e një blloku opozitar i cili jep indikacione për bashkëndim të aktiviteteve dhe politikave për periudha kohore më të gjata, e jo vetëm në mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë aktuale. Nëse iniciativa e opozitës ka sukses, Kryeziu ka theksuar se zgjedhjet do të duhej të mbaheshin këtë vit

## Veseli padit grupin e fajdexhinjve që thotë se ia keqpërdorën emrin

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë me dije se nuk i njeh dhe nuk ka të bëjë asgjë me personat të cilët ia kanë përmendur emrin në një aferë korruptive. Ai në një konferencë për media mbajtur të enjten është zotuar se nëse del vetëm një indikacion i përfshirjes së tij në këtë aferë, është i gatshëm të

japë menjëherë dorëheqje. Lideri i PDK-së ka bërë kallëzim penal ndaj grupit të personave që kanë keqpërdorur emrin e tij. Veseli ka deklaruar se video shpërfaq krimin në mënyrë të hapur, duke shtuar se kur të sqarohet e vërteta e kësaj ngjarje, dikush duhet të japë llogari penale dhe institucionale



Mali i Pashtrikut dhe liqeni i Vermicës shpallen zona të mbrojtura

**RENOVA**  
PUTZ  
Magëdoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Zgjedhjet në Shqipëri nuk mund të zhvillohen pa opozitën

**BERLIN, 23 MAJ** - Unioni Kristiandemokrat dhe Kristiansocial (CDU/CSU) përmes një deklarate për Deutsche Welle-n shpreh shqetësimin për gjendjen në Shqipëri. Ndër të tjera sugjerohet shtyrja e datës së zgjedhjeve. Kjo është hera e parë që ndërkombëtarët flasin në mënyrë konkrete sesi mund të zgjidhet kriza politike.

Në një deklaratë të përbashkët, dy deputetët, Johann David Wadehul, zëvendëskryetar i grupit parlamentar CDU/CSU në Parlamentin gjerman dhe njëherazi drejtues i grupit të punës së Ballkanit Perëndimor, si

dhe Christian Schmidt, CSU, raportuesi për Shqipërinë në Komisionin e Jashtëm dhe ish-ministër federal, shprehin shqetësimin e tyre për krizën e brendshme politike në Shqipëri dhe për zgjedhjet lokale që do të zhvillohen pa opozitën. "Po e vëzhgojmë me shqetësim të madh krizën e brendshme në Shqipëri. Për të ardhmen evropiane të Shqipërisë nevojitet dialogu mes qeverisë dhe opozitës. Për këtë, të dyja palët duhet të afrohen me njëra-tjetrën dhe të jenë të gatshme për kompromise.

Protestat e përsëritura në Shqipëri janë një shenjë e pakë-

naqësisë së shumë qytetarëve. Ne bëjmë thirrje që protesta të jetë paqësore. Aktet e dhunës i dënojmë thellësisht. Është përgjegjësia e vendimmarrësve të politikës që të sillen të arsyeshëm në këtë situatë dhe që me të gjitha forcat të përpiqen për ta qetësuar gjendjen. Nëse kjo nuk do të ndodhë, ekziston rreziku që vendit t'i mbyllet rruja drejt Evropës", thuhet në deklaratën e tyre.

Ata thonë se jemi edhe më tej të gatshëm që të kontribuojmë për hapjen e një dialogu ndërmjet qeverisë dhe opozitës për të kapërcyer krizën. "Kjo mund të funksionojë vetëm nëse të dyja palët hyjnë në bisedime pa ven-



dosur parakushte. Gjithashtu nuk duhet të përjashtohet asnjë temë. Zgjedhjet pa pjesëmarrjen e opozitës janë problematike në aspektin demokratik. Prandaj duhen vënë në tryezë të gjitha

opsionet që u garantojnë qytetarëve dhe qytetarëve mundësi të vërteta për të zgjedhur në zgjedhjet lokale", thuhet në deklaratën e deputetëve gjermanë.

## Rama sërish i bën ftesë Bashës për dialog

Në letrën e dytë dërguar liderit demokrat Lulzim Basha, kryeministri Edi Rama thotë se pa humbur durimin, në të vetmen rrugë që njeh demokracia, dialogun, mbetem i vendosur t'ju ofroj të gjithë gatishmërinë time për t'i hapur rrugë dialogut

**TIRANË, 23 MAJ** - Pa u mbushur ende 24 orë nga letra me ftesën për dialog të Edi Ramës për Lulzim Bashën, e refuzuar nga kryedemokrati, kryeministri i dërgon edhe një letër. "Nuk jam aspak i çuditur me refuzimin brutal të dialogut nga ana juaj", thotë Rama në krye të letrës. "Duke qenë se detyrimi im është të këmbëngul, pa humbur durimin, në të vetmen rrugë që njeh demokracia, dialogun, mbetem i vendosur t'ju ofroj të gjithë gatishmërinë time, për t'i hapur rrugë dialogut", shkruan kryeministri.

Rama i drejtohet Bashës me fjalët se është në të drejtën e kreut të PD-së ta udhëheqë grupimin e tij politik drejt humnerës. "Ju jeni, po ashtu, në të drejtën tuaj të synoni tërheqjen pas jush të pak individëve që mbase, kushedi, mund të jenë gati të kryejnë krime zgjedhore e

të humbasin lirinë e tyre, sipas parashikimeve të Kodit Penal për ato krime dhe më tej akoma, t'i thonë lamtumirë edhe lirisë së hyrjes në SHBA dhe në vendet e Bashkimit Evropian, si persona të padëshirueshëm në një botë që rrotullohet përmes zgjedhjeve demokratike, jo përmes dhunës mbi to", shton ai më tej. Rama rithekson se Basha është futur në një aventurë të pashoqe me pak përkrahje. "Kështu që përsëri ju bëj publikisht thirrje: Ejani të ulemi në tryezën e dialogut! Pa kushte dhe pa humbur kohë. Fushata e zgjedhjeve nis zyrtarisht më 31 maj dhe ditët e numëruara që kanë mbetur, duhen shfrytëzuar për dialog politik, jo humbur me kërcënimet e dëshpëruara dhunë nxitëse që nuk ju turpërojnë vetëm juve, po edhe vendin tonë e të gjithëve ne bashkë me të", shkruan ai.



Shqipëria thekson kryeministri, s'ka kohë për të humbur për llogaritë e gabuara politike dhe aventurat antidemokratike të kujtdo qoftë. "Ejani në dialog të arsyetojmë si njerëz me përgjegjësi të mëdha dhe t'i ballafaqojmë divergjencat tona të mëdha, me forcën e arsyes, përpara se sa inercia e rrugës së gabuar që keni marrë t'ju ketë degdisur në esfeltin e irrelevantës politike, me gjithë grupimin tuaj. Edhe njëherë, mua s'më duhet fati juaj politik

dhe as fati politik i atij grupimi - madje sipas meje, troç fare, rrënim i plotë me duart tuaja i grupimit që po udhëhiqni qorrazi është ogur i mirë për këtë vend e për vetë të ardhmen e institucionit të pazëvendësueshëm të opozitës - por ky moment me rëndësi të veçantë për Shqipërinë, më imponon t'ju lutem të ktheni rrugë!", thuhet më tej në letër.

Këtë letër Edi Rama e ka përdorur për të komentuar indirekt edhe qëndrimet kritike të presi-

dentit Meta për reformën në drejtësi. "Duke ju garantuar se jam në dispozicionin tuaj, në çdo moment dhe pa kushte për një dialog për Shqipërinë, si edhe duke ju siguruar se sikur të tërë të dëshpëruarit nga reforma në drejtësi të hidhen përpjetë, nuk kanë për të ndalur dot as zbatimin e reformës në drejtësi, as zhvillimin e zgjedhjeve më 30 qershor", shkruan Rama në letrën e dytë, të cilën e mbyll me fjalët: "Uroj rikthimin Tuaj sa më të shpejtë në rrugën e arsyes".

## Fillojnë votimet për Parlamentin Evropian

**BRUKSEL, 23 MAJ** - Kutitë e votimit u hapën të enjten në Holandë dhe Mbretërinë e Bashkuara, duke filluar zgjedhjet katërditëshe për Parlamentin Evropian, që do të mbahen në të 28 vendet e bllokut, ku po përballen përkrahësit e integritit më të thellë me "euro skeptikët" popullsitë, që duan më shumë pushtet për qeveritë e tyre

kombëtare. Gjysmë ore pas fillimit të votimit në Holandë, kutitë u hapën gjithandej Mbretërisë së Bashkuar, e cila po përpëllitet me planet e saj për t'u larguar nga Bashkimi Evropian. Mbi 400 milionë qytetarë me të drejtë vote gjithandej Evropës, do të zgjedhin 751 ligjvënës, numri i të cilëve do të bjerë në 705, kur

Mbretëria e Bashkuara të largohet nga Bashkimi Evropian. Mbretëria e Bashkuar ka 73 ligjvënës, që do të mbesin pa punë kur vendi i tyre të përmbyllet procesin e ndarjes nga BE-ja. Deputetët e rinj të Parlamentit Evropian me mandat pesëvjeçar, do të shqyrtojnë dhe miratojnë ligje të propozuara nga Komisioni

Evropian, të cilat më pas gjithashtu do të duhet të miratohen nga qeveritë e vendeve anëtare të BE-së.

Anketat flasin për rritje të forcave nacionaliste në zgjedhjet e sivjetme, që janë të nëntat me radhë për Parlamentin Evropian qëkur janë mbajtur zgjedhjet e para në vitin 1979.



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mohuar përfshirjen në pretendimet për keqpërdorime

## Veseli padit grupin e fajdexhinjve që ia keqpërdorën emrin

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë me dije se nuk i njeh dhe nuk ka të bëjë asgjë me personat të cilët ia kanë përmendur emrin në një aferë korruptive. Ai në një konferencë për media të enjten është zotuar se nëse del vetëm një indikacion i përfshirjes së tij në këtë aferë është i gatshëm të japë menjëherë dorëheqje. Lideri i PDK-së ka bërë kallëzim penal ndaj grupit të personave që kanë keqpërdorur emrin e tij. Veseli ka deklaruar se video shpërfaq krimin në mënyrë të hapur, duke shtuar se kur të sqarohet e vërteta e kësaj ngjarje, dikush duhet të japë llogari penale dhe institucionale



### Veseli padit grupin e fajdexhinjve, rastit do t'i shkojë deri në fund

Kryetari i Partisë Demokratike, njëherësh kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë kallëzim penal ndaj një grupi të personave që kanë keqpërdorur emrin e tij. Ai është zotuar se do t'i shkojë deri në fund qartësimi të këtij rasti dhe sjelljes para përgjegjësive

penale për të gjithë të përfshirët, ata që e kanë bërë krimin dhe ata që e kanë fshehur krimin për gjashtë vjet. "Sot kam deponuar kallëzim penal në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës për shkak të keqpërdorimit të emrit tim nga një

grup kriminal. Unë do t'i shkojë deri në fund qartësimi të këtij rasti dhe sjelljes para përgjegjësive penale për të gjithë të përfshirët, ata që e kanë bërë krimin dhe ata që e kanë fshehur krimin për gjashtë vjet", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 23 MAJ** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mohuar përfshirjen në pretendimet për keqpërdorime. Pas publikimit të një video-incizimi, në të cilën shihen disa persona të dyshuar për vepra kriminale, duke marrë para dhe duke u thirrur në emrin e tij, Veseli ka thënë se nuk ka të bëjë asgjë me këtë rast dhe as me personat e përfshirë në këtë rast.

Në një konferencë për media, lideri i PDK-së ka kërkuar përgjegjësi nga organet e rendit dhe drejtësisë pasi, sipas tij, sipas videove të publikuara në media, organet e rendit i kanë pasur këto video që gjashtë vjet dhe nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim ligjor. "Gjatë kësaj jave disa media kanë publikuar video-materiale nga një rast i krimit të organizuar, ku është apostrofuar emri im nga protagonistët e incizimit, të cilët janë të dyshuar për krime të fajdesë, mashtrimit dhe krime të tjera të rënda. Dua të deklaroj se unë nuk kam të bëjë asgjë me këtë rast dhe as me personat e përfshirë në këtë rast. Ky është një rast klasik i mashtrimit dhe i manipulimit, për çfarë jam i bindur se edhe organet e hetuesisë dhe të drejtësisë kanë qenë në dijeni me kohë", ka thënë Veseli. Ai i ka siguruar qytetarët e Kosovës

se nëse del vetëm një indikacion i përfshirjes së tij në këtë aferë është i gatshëm të japë menjëherë dorëheqje.

Kryeparlamentari Veseli ka deklaruar se kur të sqarohet e vërteta e kësaj ngjarje, dikush duhet të japë llogari penale dhe institucionale. "Nëse del se është e vërtetë se jam përfshirë në këtë rast unë jam i gatshëm nga sot të jap dorëheqje. Ky është morali im. Ky është besimi im jetësor. Kjo është politika ime. E them me siguri të plotë: emri im është keqpërdorur në këtë akt kriminal të mashtrimit. Kur të dalë e vërteta e kësaj, atëherë dikush duhet të japë llogari penale dhe institucionale, pavarësisht a janë pjesë e policisë, sistemit të drejtësisë, ose politikës", ka thënë Veseli.

Kreu i Kuvendit të Kosovës ka kërkuar të sqarohen disa çështje që mund të ngriten natyrshëm nga ky rast dhe që ka të bëjë edhe me funksionimin e organeve dhe institucioneve të zbatimit të ligjit në Kosovë. "Si është e mundur që për këtë rast të krimit të organizuar, që paska pasur fakte në vitin 2013, të ndërmerren veprime me 6 vjet vonesë? Kush është ai, ose ata persona që e kanë mbuluar këtë krim të organizuar për më shumë se 6 vjet? Kujt dhe për çfarë llogarie i është dashur kjo vonesë që paska mundësuar edhe mbulimin dhe mosdënimin e veprave penale? Pse këto

video-incizime kanë qenë në sirtarë të policisë apo të prokurorisë për kaq shumë vjet dhe nuk janë trajtuar në kohë dhe me veprime të duhura?", ka thënë Veseli, duke shtuar se kësaj pune do t'i shkohet deri në fund. "Videoja shpërfaq krimin në mënyrë të hapur, të qartë, për secilin qytetar, e lëre

më për organet e drejtësisë. Këtu kemi të bëjmë me dy krime. Me krimin e bërë dhe krimin e fshehur. Gjashtë vjet të mbahet krimi i fshehur, është krim edhe më i madh. Pa asnjë dyshim, duket qartë se kjo është një skemë e krimit të organizuar dhe po ju siguroj se kësaj pune do t'i shkohet deri në fund. Deri në qartësimin e plotë të rastit dhe sjelljes para përgjegjësive penale të të gjithë atyre që janë të përfshirë në keqpërdorimin dhe tentimin për njollosje të emrit tim. Dikush duhet të marrë përgjegjësi. Dikush duhet të përgjigjet për tërë këtë", ka thënë kryeparlamentari.

Nënshkrimi i një kontrate dhe marrja e lejes për ndërtimin e një spitali në hapësirat e QKUK-së dyshohet se ka përfshirë në fajde, mashtrim dhe detyrim, një grup prej së paku tetë personash. Dy protagonistët në

këtë video flasin për shumën e mëdha parash që biznesmeni Faton Dalladaku thotë se i dha për t'u ndërtuar spitali privat. Teksa flasin për Rrahim Hashimin, si personi që do t'i ndihmonte Dalladaku për ta ndërtuar spitalin, ky i fundit, për këtë, përmend edhe emrin e Kadri Veselit.

Personi tjetër në këtë video është Kadri Rexhepi që duket se luan rolin e ndërmjetësuesit mes Rrahim Hashimit e Faton Dalladaku.

Të hënën policia ka arrestuar pesë persona: Rrahim Hashimin, Ismet Osmanin, i njohur si "Curri", Ilir Bojkun, Mentor Maqanin dhe Adil Thaqin, nën dyshimin për fajde, detyrim dhe mashtrim. Gjykata Themelore e Prishtinës ka refuzuar kërkesën për një muaj paraburgim për Rrahim Hashimin, ndërkaq katër të tjerëve u janë caktuar 30 ditë paraburgim.

### Hoxhaj: PDK-ja e kishte denoncuar këtë grup kriminal në vitin 2014

Zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka deklaruar se grupin kriminal, i cili në disa video-incizime përmend emrin e kryeparlamentarit Kadri Veseli, ky subjekt politik e kishte denoncuar në polici në vitin 2014. Në një konferencë për media, Hoxhaj ka treguar se denoncimi ka ndodhur nga

deputeti i PDK-së, Xhavit Haliti. "Rrahim Hashimi, personi kyç në këtë grup kriminal, është denoncuar në vitin 2014 nga nënkryetari i PDK-së dhe Kuvendit pasi që ia kishte emrin, njësoj si tani. Tani pyetja është pse nuk u hetua ky rast deri në fund. Rasti për të cilin ka qenë subjekt kjo

video është mbyllur pa përfunduar hetimet dhe pa u vënë para përgjegjësive penale aktorët e këtij krimi të organizuar", ka deklaruar Hoxhaj. Ai ka deklaruar se ky rast qëllimisht është penguar, duke shtuar se rasti duhet të zbardhet deri në fund.

Flet për "Epokën e re", Ismet Kryeziu

# Samiti i Parisit do të jetë një pikë



Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) ka vlerësuar se takimi i kryeministrit Haradinaj me kancelaren Merkel do t'i shërbejë Kosovës për ta adresuar agjendën e integritimit evropian dhe liberalizimin e vizave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se Samiti i Parisit do të jetë një pikë kthese nga dy shtetet për t'iu rikthyer tryezës së dialogut përmes së cilës do të synohet potencialisht arritja e një marrëveshjeje. Duke folur për zhvillimet në vend, Kryeziu ka thënë se LDK-ja dhe Vetëvendosja po synojnë krijimin e një blloku opozitar i cili jep indikacione për bashkërendim të aktiviteteve dhe politikave për periudha kohore më të gjata, e jo vetëm në mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë aktuale. Nëse iniciativa e opozitës ka sukses, Kryeziu ka theksuar se zgjedhjet do të duhej të mbaheshin këtë vit

shpeshherë edhe qasje kritike ndaj njëra-tjetres. Këtë frymë të bashkëpunimit mes subjekteve politike tek ne, përveç votës qytetare, në masë të konsiderueshme e imponon edhe legjislacioni aktual", është shprehur Kryeziu, duke shtuar se nëse iniciativa e opozitës ka sukses, atëherë zgjedhjet e reja do të duhej të mbaheshin këtë vit. "Kjo varet nga dinamika e kësaj nisme dhe nëse arrihet shumica parlamentare e nevojshme për ta shprehur mosbesimin ndaj kësaj qeverie, atëherë zgjedhjet do duhej të ndodhnin këtë vit. Por, nisma për mocionin e mosbesimit nuk është e sotshme dhe deri tani gati mbas dy vjet qeverisje ende nuk është arritur që të sigurohet numri i mjaftueshëm i deputetëve të cilët përmes votës shprehin mosbesimin ndaj kësaj qeverie", ka deklaruar ai. Sa i përket funksionimit të Kuvendit të Kosovës, Kryeziu ka

vlerësuar se mungesa e kuorumit është problemi më i madh me të cilin ballafaqohet Kuvendi dhe, për pasojë, nuk po arrin ta luajë mjaftueshëm rolin e tij përfaqësues, ligjvënës e as mbikëqyrës. "Sigurse qeveria dhe opozita janë medalje me dy anë. Ka pasur vendime të rëndësishme të cilat qeveritë paraprake me vite qeverisje s'kanë arritur t'i shtyjnë tutje, shpeshherë duke i mbajtur ato vendime peng të interesave partiake, sikurse ka dhe vendime të cilat janë përcjell me shumë kritika dhe pa llogaridhënien e mjaftueshme për publikun", ka theksuar Kryeziu.

Në këtë intervistë Kryeziu ka folur edhe për takimin e kryeministrit Ramush Haradinaj me kancelaren Angela Merkel, duke thënë se ky takim do t'i shërbejë Kosovës për ta përgatitur Samitin e Parisit, por dhe për ta adresuar agjendën e saj të integritimit evropian, veçanërisht liberaliz-

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 MAJ - Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë të enjten se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) po synojnë krijimin e një blloku opozitar i cili jep indikacione për bashkërendim të aktiviteteve dhe

politikave për periudha kohore më të gjata, e jo vetëm në mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë aktuale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se është legjitim secili mobilizim i opozitës që përmes një mocioni mosbesimi ta krijojë rrëzimin e qeverisë dhe përmes garës zgjedhore ta kërkojë besimin qytetar për një qeverisje alternative.

"Konsideroj se është një iniciativë në frymën e bashkëpunimit të një blloku opozitar, i cili jep indikacione për një bashkërendim të aktiviteteve dhe politikave për periudha kohore më të gjata, e jo vetëm në mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë aktuale. Partitë politike, varësisht nga analizat, vlerësimet dhe strategjitë e tyre, ndërtojnë bashkëpunim ose koalicion me subjektet e tjera,

# kthese për vazhdimin e dialogut

aspekt të qeverisjes. Prandaj është legjitim secili mobilizim i opozitës që përmes një mocioni mosbesimi të krijojë rrëzimin e qeverisë dhe përmes garës zgjedhore ta kërkojë besimin qytetar për një qeverisje alternative.

**"Epoka e re":** Duke pasur parasysh raportet e këtyre dy partive në të kaluarën, sa ka gjasa të realizohet skenari i LDK-së dhe i Vetëvendosjes, eventualisht me mbështetjen e PSD-së dhe Listës Serbe?

**Kryeziu:** Konsideroj se është një iniciativë në frymën e bashkëpunimit të një blloku opozitar, i cili jep indikacione për një bashkërendim të aktiviteteve dhe politikave për periudha kohore më të gjata, e jo vetëm në mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë aktuale. Partitë politike, varësisht nga analizat, vlerësimet dhe strategjitë e tyre, ndërtojnë bashkëveprim ose koalicion me subjekte të tjera, shpeshherë edhe qasje kritike ndaj njëra-tjetrës. Këtë frymë të bashkëveprimit mes subjekteve politike tek ne, përveç votës qytetare, në masë të konsiderueshme e imponon dhe

legjislacioni aktual.

**"Epoka e re":** Kur parashihni mbajtjen e zgjedhjeve të reja, në këtë apo në vitin tjetër?

**Kryeziu:** Kjo varet nga dinamika e kësaj nisme dhe nëse arrihet shumica parlamentare e nevojshme për ta shprehur mosbesimin ndaj kësaj qeverie, atëherë zgjedhjet do të duhej të ndodhnin këtë vit. Por, nisma për mocionin e mosbesimit nuk është e sotshme, dhe deri tani, gati mbas dy vjetësh qeverisje, ende nuk është arritur të sigurohet numri i mjaftueshëm i deputetëve të cilët përmes votës shprehin mosbesimin ndaj kësaj qeverie.

**"Epoka e re":** Mendoni se zgjedhjet do të ishin zgjidhja e duhur për përmirësimin e gjendjes në vend?

**Kryeziu:** Varësisht se si e lexoni gjendjen në vend. Për shembull, çështja e dialogut dhe marrëveshja përfundimtare me Serbinë do të kërkonte një gjithëpërfshirje të aktorëve politikë, e këtë situatë s'mendoj se e ndryshojnë zgjedhjet. Derisa në qeverisjen e brendshme si në llogaridhënie, transparencë dhe qeverisje të mirë mund dhe

të ketë përmirësim ose përqendrim, varet se cilat janë ofertat dhe për çka përcaktohen qytetarët. Skena politike aktuale, së paku pas pavarësisë, s'ka lejuar asnjë qeveri ta konsumojë mandatin e plotë, kanë ndryshuar partnerët qeverisës, kryeministra e ministra por, në thelb, pak ose aspak s'kanë ndryshuar modelin qeverisës.

**"Epoka e re":** Si e vlerësoni funksionimin e Kuvendit dhe rolin e tij në proceset e rëndësishme?

**Kryeziu:** Mungesa e kuorumit është problemi më i madh me të cilin ballafaqohet Kuvendi, meqenëse tash e sa kohë nuk ka shumicë parlamentare në Kuvend dhe, si pasojë, nuk arrin ta luajë mjaftueshëm rolin e tij përfaqësues, ligjvënës e as mbikëqyrës. Vetëm në muajin maj, për shkak të mungesës së kuorumit, kanë dështuar tetë mbledhje.

**"Epoka e re":** Çfarë vlerësimi keni për qeverisjen e deritashme dhe rolin e opozitës?

**Kryeziu:** Sikurse, qeveria dhe

opozita janë medalje me dy anë. Ka pasur vendime të rëndësishme të cilat qeveritë paraprake me vite qeverisje s'kanë arritur t'i shtyjnë tutje. Shpeshherë duke i mbajtur ato vendime peng të interesave partiake. Sikurse ka dhe vendime të cilat janë përcjell me shumë kritika dhe pa llogaridhënie e mjaftueshme për publikun.

**"Epoka e re":** Muajin e ardhshëm është paralajmëruar një takim i kryeministrit Haradinaj me kancelaren Merkel. Çfarë do të thotë ky takim për Kosovën? Dhe cilat janë pritjet për Samitin e Parisit që do të mbahet më 1 korrik?

**Kryeziu:** Takimi me Merkelin do t'i shërbejë Kosovës për ta përgatitur Samitin e Parisit, por edhe për ta adresuar agjendën e saj të integriteteve evropiane, veçanërisht liberalizimin e vizave. Derisa nga Samiti i Francës besoi se do të jetë një pikë kthese nga dy shtetet për t'iu rikthyer tryezës së dialogut, përmes së cilës do të synohet potencialisht arritja e një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të obligueshme.

## Plani për tranzicionin e FSK-së do të zbatohet në tri faza

PRISHTINË, 23 MAJ (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, dhe komandanti i FSK-së, gjeneraljtënant Rrahman Rama, kanë pritur të enjten në ministri deputetët e Kuvendit të Kosovës, anëtarë të Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, të prirë nga kryetar i këtij Komisioni, Haxhi Shala.

Ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, ka falënderuar deputetët pjesëmarrës për vizitën, bashkëpunimin dhe

përkrahjen e vazhdueshme për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast, ministri Berisha i ka njoftuar deputetët me zhvillimet më të reja në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-së. Ministri Berisha në veçanti ka folur për planin gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së, i cili do të implementohet gradualisht në tri faza gjatë dhjetë vjetëve të ardhshëm, deri në arrijten e kapaciteteve të plota operacionale.

Ministri Berisha ka theksuar se tranzicioni do të bëhet në koor-

dinim me partnerët strategjikë të Republikës së Kosovës. Plani pastaj u prezantua para deputetëve në hollësi nga kolonel Haki Hoti, drejtor i Departamentit për Transformim, Modernizim dhe Standardizim. Ministri Berisha dhe gjenerali Rama gjithashtu i njoftuan deputetët e Komisionit Parlamentar edhe për sukseset dhe sfidat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Në emër të deputetëve të Komisionit Parlamentar për

Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, kryetari Haxhi Shala ka shprehur falënderimin për pritjen si dhe ka përgëzuar ministrin Berisha dhe komandantin Rama për zhvillimet pozitive të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Deputetët parashtruan pyetje të cilat kishin të bënin kryesisht me zhvillimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Gjithashtu, shprehën përkrahjen e tyre për përkrahje të mëtutjeshme në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

imin e vizave. Ndërsa për Samitin e Parisit ai ka thënë se do të jetë një pikë kthese për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi. "Nga Samiti i Francës besoj se do të jetë një pikë kthese nga dy shtetet për t'iu rikthyer tryezës së dialogut përmes së cilës do të synohet arritja e një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të obligueshme", ka deklaruar Kryeziu.

**"Epoka e re":** Z. Kryeziu, në kuadër të koordinimit për rrëzimin e qeverisë, të martën janë takuar lideri i Lëvizjes Vetëvendosjes, Albin Kurti dhe lideri i LDK-së, Isa Mustafa. Si e komentoni iniciativën për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë?

**Kryeziu:** Opozita në sistemet parlamentare s'ka asnjë instrument të ngjashëm apo më të fuqishëm sesa mocioni i mosbesimit ndaj një qeverisje, qoftë edhe për një



## Policia e Kosovës dhe ajo e Gjermanisë rrisin bashkëpunimin

PRISHTINË, 23 MAJ (ER) - Me ftesë të presidentit të Policisë Federale të Gjermanisë, Dieter Roman, që nga data 21 deri më 23 maj në Policinë Federale të Gjermanisë ka qëndruar për vizitë zyrtare drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, i cili ishte i shoqëruar nga drejtori i Departamentit të Policisë kufitare, Shaban Guda, atashu i Policisë Driton Vrajolli dhe zyrtari i Ambasadës së Kosovës, Lulzim Pllana.

Roman dhe Qalaj janë marrë vesh që bashkëpunimi bilateral mes dy policive do të rritet dhe dy institucionet do ta mbështesin njëra-tjetrën në këtë rrugëtim. Gjatë takimit u tha se përvojat e mira të bashkëpunimit në mes të

dy policive do të vazhdojnë dhe ato vetëm sa do të shtohen në fusha të ndryshme të sigurisë si: kontrolli kufitar, shkëmbimi i informacioneve, trajnimi në fusha të ndryshme të sigurisë, shkëmbimi i programeve në avancimin e Policisë dhe mbështetja në fusha të ndryshme të sigurisë.

Në kuadër të vizitës drejtori Qalaj ka vizituar edhe Departamentin e Fluturimit, patrullimit me helikopter si dhe një pikë të përbashkët kufitare në mes të Gjermanisë dhe Polonisë. Të dy homologët e vlerësuan lart takimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë policor, duke theksuar se takimet e tilla do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.



## Ministri Tahiri: Legjislacioni mundëson luftë më të ashpër kundër korrupsionit



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 MAJ - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka marrë pjesë të enjten në publikimin e "Raportit të monitorimit të gjykatave 2018", hartuar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese. Tahiri ka vlerësuar punën e bërë në raport, duke theksuar se gjetjet do t'i ndihmojnë institucionet për rritjen e efikasitetit të sistemit të sundimit të ligjit. Ministri Tahiri ka theksuar se nga nisja e mandatit të tij është

përqendruar në rritjen e kapaciteteve të gjyqësorit, duke rritur në 430 numrin e gjyqtarëve, rritjes së numrit të prokurorëve dhe 250 të punësuar si staf mbështetës, rritjen e buxhetit për Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial si dhe rritjes së pagave.

Duke folur për problemet në strukturimin dhe shkallshmërisë së gjykatave, ministri Tahiri ka theksuar se ky problem dhe shumë të tjera do të gjejnë zgjidhje përmes Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit. "Pres që

Strategjia nga Rishikimi Funkcional të jetë gati më së largu në tetor të këtij viti, pastaj ta fillojmë zbatimin e saj në katër apo pesë vjetët e ardhshëm, aq kohë sa të na duhet për të zbatuar. Kemi pasur ngecje, duke qenë vendi i vetëm në rajon pa strategji të sektorit të sundimit të ligjit dhe pas shumë vitesh po e adresojmë edhe këtë çështje", ka thënë ministri Tahiri.

Reformat legjislative kanë qenë një nga fokuset e tjera, ka theksuar ministri Tahiri.

Pas Kodit Penal, ministri ka

theksuar ndryshimet e bëra në draft Kodin e ri të Procedurës Penale, si dhe ndryshimet e bëra në ligjin e ri për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së fituar me veprë penale. "Ligji i ri jam i bindur se do t'i jap rezultatet e veta. Duhet të tregojmë më shumë sukses sesa në vitet e tjera në konfiskimin e pasurisë. Jemi në proces të themelimit të Fondit të Konfiskimit, që aty të mblidhen mjetet që do të merren nga konfiskimi i aseteve dhe aty do të matim se sa po arrijmë të shënojmë përparim në këtë

drejtim", ka thënë Tahiri. Ministri Tahiri ka potencuar se luftimin e korrupsionit e kanë ndihmuar edhe dy ligjet e reja: ai për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. "Na takon të gjithëve që ta adresojmë fenomenin, papërgjegjësinë, problemet me të cilat ballafaqohemi dhe ne nuk do të rrimë duarkryq në rast se baza ligjore është pengesë për avancimin ose për përparimin që duhet ta krijojmë në fushën e drejtësisë", ka përfunduar ministri Tahiri.

## Në Kirurgjinë Torakale operohen 50 pacientë me pajisjen bashkëkohore

Prishtinë, 23 maj (ER) - Pas pajisjes me skalperin ultrasonik nga ana e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë, mjekët e Klinikës së Kirurgjisë Trokale kanë operuar 50 pacientë të cilët më parë ishin operuar me metoda

klasike. Përmes saj është rritur performanca profesionale, por kanë përfituar pacientët ngaqë gjatë ndërhyrjes ka pak gjakderdhje e dhimbje.

Njëkohësisht është shkurtuar koha e operimit, është mundësuar mbrojtja e strukturave

anatomike përreth dhe gjatë pre-rjes në operacion

Një operacion i tillë jashtë vendit ka kushtuar 25 deri në 30 mijë euro, përderisa nga muaji shkurt, kur ka hyrë në punë kjo aparaturë, pacientët po e marrin shërbimin në klinikë.



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

# Mali i Pashtrikut dhe liqeni i Vermicës shpallen zona të mbrojtura



Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës të enjten është aprovuar Projektligji për Pyjet, nisma për funksionalizimin dhe dhënie në shfrytëzim të Qendrës së Panairëve në Bërnice dhe vendimi për shpalljen e Zonës së Mbrojtur në Kategorinë e Parkut Natyror "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës"

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 MAJ - Kabineti qeveritar në mbledhjen e së enjtes ka aprovuar konceptdokumentin për reformën e procedurave të përkthimit brenda Qeverisë së Kosovës drejt një legjislacioni të harmonizuar shumëgjuhësh, i cili ka për qëllim themelimin e Njësisë Qendrore të Përkthimit, njësinë për kontrollin dhe harmo-

nizimin gjuhësor në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe futjen e lekturës dhe përkthimit kualitativ profesional që ka për bazë ndërtimin e një kujtese qendrore të përkthimit, zhvillimin e terminologjisë e fjalorit si dhe analizën e cilësisë.

Po në këtë mbledhje, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Projektligjin për Pyjet, i cili ka për qëllim krijimin e bazës ligjore dhe tokave pyjore si resurse të ripërtërishte

me interes të përgjithshëm si dhe ka aprovuar vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 32/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Integritimit Evropian.

Nisma për nënshkrimin e marrëveshjes financiare trepalëshe ndërmjet Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Shqipërisë për vitin 2018, për programin e bashkëpunimit ndërkufitar për IPA II ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë; Nisma për negociimin e Marrëveshjes për Amendamentimin e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), për financimin e projektit "Mënjanimi i ujërave të zeza në Kosovën Jugperëndimore-

Faza V" si dhe Nisma për lidhjen e memorandumit të partneritetit për "Iniciativat Kombëtare të Frankofonisë", ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë, morën gjithashtu aprovimin e kabinetit qeveritar.

Një tjetër vendim i rëndësishëm i kësaj mbledhje ishte edhe shpallja e Zonës së Mbrojtur në Kategorinë e Parkut Natyror "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës", derisa me propozim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë u aprovua edhe nisma për funksionalizimin dhe dhënie në shfrytëzim të Qendrës së Panairëve në Bërnice.

Kabineti qeveritar mori vendim për riemërimin e Arben Gashit inspektor incizues i fluturimeve në Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve

Aeronautike (KHAIA), e cila vepron në kuadër të zyrës së kryeministrit. Me qëllim të finalizimit në zbatim të ligjeve për reformën e administratës publike, qeveria mori vendim për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 95 000 eurosh për hartimin e akteve nënligjore dhe përgatitjet e nevojshme për zbatimin e ligjeve për reformën e administratës publike.

Në fund të mbledhjes së qeverisë, kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar sqarime nga ministrat e resorëve përkatës lidhur me përshejtimin e procedurave për hartimin e konceptdokumentit për Bjeshkët e Nemuna dhe shqetësimet e banorëve të disa rajoneve që preken nga ndërtimi i autostradës Prishtinë - Hani i Elezit.



## Mustafa dhe Minxhozi diskutojnë për fushën e sigurisë

PRISHTINË, 23 MAJ (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. Në këtë takim të dy bashkëbiseduesit diskutuan për marrëdhëniet e mira ndërmjet dy vendeve,

bashkëpunimin e ngushtë sidomos në fushën e sigurisë.

Gjithashtu, në takim u bisedua edhe për kontrollin e përbashkët të pikave kufitare, ku u vlerësua bashkëpunimi i suksesshëm i patrullimeve të përbashkëta policore, sidomos gjatë sezonit

veror kur shtohet fluksi i lëvizjes së qytetarëve.

Ministri Mustafa dhe ambasadori Minxhozi diskutuan edhe për modalitetet rreth zgjerimit të kapaciteteve në pikën e kalimit kufitar në Krushevë të Komunës së Dragashit.

## Haradinaj dhe Jahjaga koordinohen për shënimin e 20-vjetorit të intervenimit të NATO-s

PRISHTINË, 23 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim ish-presidenten Atifete Jahjaga, me të cilën ka biseduar për bashkëpunimin e veprimeve institucionale për shënimin e 20-vjetorit të intervenimit të NATO-s në vendin tonë kundër

Serbisë. "Me ish-presidenten Jahjaga pata kënaqësinë që t'i bashkërendojmë veprimet për shënimin e 20-vjetorit të intervenimit të NATO-s në Kosovë, në muajin qershor, një ngjarje madhështore në shenjë mirënjohje për rolin vendimtar të Paktit Veri-Atlantik në

çlirimin e Kosovës. Presidenten Jahjaga e falënderova për përkushtimin e saj në përfaqësimin e grupeve të marginalizuara, veçanërisht mbështetjes së merituar për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, duke u bërë zëri i tyre!", ka thënë Haradinaj.





## Lluka: Energjia e pastër do të jetë gjeneruesja kryesore e vendeve të punës

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 23 MAJ** - Në Prishtinë është mbajtur ngjarje njëditore e lansimit të Rrjetit të Bizneseve për Energji të Pastër (N4CEB), ku po marrin pjesë përfaqësues nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përfaqësues nga sektori privat, institucionet financiare dhe nga academia. Kjo ngjarje ka për qëllim që t'i japë sektorit privat një zë më të fortë duke promovuar një rrjet të fuqishëm dhe zhvillimin e tregut të energjisë.

Në këtë ngjarje ka marrë pjesë ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, i cili para të pranishmëve ka theksuar se tranzicioni në sektorin e energjisë mbetet një prej sfidave kryesore, mirëpo Kosova, edhe përkundër faktit që përballet me sfida të

shumta, në këtë fushë ka shënuar përparim. "Investimet në fushën e energjisë së ripërtëritshme, përkundër rritjes, ende nuk e kanë përmbyshur targetin e paraparë. Sot ne kemi në operim shtatë hidrocentrale, pesë impiante e panele solare dhe dy të erës, me një kapacitet prej rreth 77 megavatesh. Ndërkaq 22 gjeneratorë janë në proces të ndërtimit me kapacitet rreth 178 megavat", u shpreh Lluka.

Por, pavarësisht prej të arriturave, ministri Lluka ka përmendur edhe sfidat me të cilat mund të përballet Kosova në të ardhmen sa i përket sektorit të energjisë siç janë: përmbyshja e targetave të rinj që dalin nga Plani për Energji dhe Klimë 2012-2030 si dhe kalimi nga procedura e autorizimit në

procedura të skemave konkurruese të tregut. "Kur jemi te Plani për Energji dhe Klimë një target tjetër do të jetë sfidues për Kosovën që lidhet me fushën e eficiencës së energjisë. Aprovimi i ligjit për EE, themelimi i Fondit për EE, zhvillimi i planeve komunale të EE si dhe forcimi i infrastrukturës administrative janë reforma që ndjeshëm do ta prekin incentivën për mobilizim të investimeve në këtë fushë si dhe krijimin për zhvillim të biznesit", ka thënë Lluka.

Ministri Lluka ka theksuar se lidhur me financimin e projekteve në fushën e burimeve të ripërtëritshme është lajm i mirë pasi janë përmbyshur të gjitha komentet e Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim që lidhen me marrëveshjen për shitblerjen e energjisë dhe së shpejti

do të jenë të gatshëm të financojnë këto projekte. "Me rritjen e investimeve në fushën e burimeve të ripërtëritshme (rreth 100 milionë euro në periudhën afatmesme së bashku me donatorët), përpos që do të kenë efekt në racionalizimin dhe optimizimin e konsumit të energjisë, po ashtu do të krijohen edhe shume vende të reja të punës nga sektori privat, që është një nga qëllimet kryesore të Qeverisë së Kosovës", ka pohuar Lluka.

I pranishëm ishte edhe ambasadori gjerman Christian Heldt, i cili ka theksuar se Kosova mund të jetë lider dhe shembull në energji të pastër. "Në Kosovë ka projekte të energjisë së pastër të cilat janë zhvilluar dhe ne besojmë se Kosova mund të jetë lidere në

rajon dhe të jetë shembull për vendet e tjera", u shpreh ai.

Kreu i MZHE-së ka treguar se iniciativa për rrjetëzimin e bizneseve të kësaj fushe na jep shpresë se Kosova do të jetë partner aktiv në propozimin dhe orientimin e politikave të reja të këtij sektori me qëllim të përbashkët për zhvillim ekonomik, krijim të vendeve të reja të punës, përmirësim të standardit të jetesës së qytetarëve tanë si dhe për një ambient më të pastër për të gjithë ne.

Kjo ngjarje u organizua nga Oda Ekonomike Gjermano - Kosovare (KDWW) në bashkëpunim me Qeverinë Gjermane përmes Projektit për Eficiencë të Energjisë në Kosovë, Deutsche Gesellschaft für internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

## Kontrollorët ajrorë pezullojnë grevën e paralajmëruar

**PRISHTINË, 23 MAJ (ER)** - Shoqata Sindikale e Kontrollorëve të Trafikut Ajror të Kosovës ka marrë vendim që ta pezullojë grevën e paralajmëruar për 27 dhe 28 maj. Ky vendim ka ardhur pas takimit të tyre me ministrin e Infrastrukturës, Pal Lekaj. "Pas takimit me ministrin Pal Lekaj, ku Këshilli Grevist i shfaqti pakënaqësitë rreth mospërmbyshjeve të obligimeve sipas afateve që burojnë nga Memorandum Mirëkuptimi (MoU), sqarimit rreth procesit dhe mungesës së informimit për SINKON-in si



dhe rikonfirmimit nga ana e tij se ju qëndron dhe do t'i respektojë

në përgjithësi të gjitha obligimet e marra, SINKON-i e pezullon

grevën e shpallur për datat 27-28 maj 2019", është thënë në njoftimin e kësaj shoqate.

Në këtë njoftim është thënë se ky vendim ka ardhur pasi Lekaj ka konfirmuar se Ministria e Infrastrukturës do t'i përmbyshë obligimet e premtuara. "Vendimin për pezullimin e grevës së paralajmëruar, SINKON-i e ndërmoi pas sqarimit të munguar gjerë më tani dhe rikonfirmimit të zotimit nga ana e ministrin se do t'i përmbyshë të gjitha obligimet që burojnë nga MoU e nën-

shkruar në muajin shkurt 2019, në mes të ministrin të MIT-së dhe SINKON-it. SINKON-i do t'i vështrojë nga afër të gjitha veprimet rreth përmbyshjes së obligimeve sipas afateve të mbetura dhe që burojnë nga MoU e lidhur mes palëve të nënshkruara. SINKON-i do t'i bëjë një vlerësim këtij procesi në fund të muajit shtator për ta parë përparimin e arritur në zbatimin e marrëveshjes varësisht prej përparimit do t'i kanalizojë veprimet e saj", është thënë në njoftimin për media.



# Fillon punën Shoqata e Inovacionit Financiar në Kosovë

Anëtarët e Shoqatës së Inovacionit Financiar të Kosovës kanë nënshkruar të enjten Standardin e Praktikave të Mira duke siguruar masa shtesë për mbrojtjen e konsumatorëve. Kryetari i Shoqatës së Inovacionit Financiar, Venhar Hana, ka thënë se meqë industria e inovacionit financiar është në fazën e saj fillestare, tanimë është thelbësore që të pajtohen për zbatimin e praktikave më të mira



**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 23 MAJ** - Anëtarët e Shoqatës së Inovacionit Financiar të Kosovës kanë nënshkruar të enjten Standardin e Praktikave të Mira duke siguruar masa shtesë për mbrojtjen e konsumatorëve. Standardi i Praktikave të Mira do të publikohet në faqen zyrtare të anëtarëve të Shoqatës ashtu që çdo përfitues i shërbimeve financiare të ketë mundësi të verifikojë nëse institucioni financiar përkatës iu përshtatet praktikave të mira dhe të përgjegjshme të përcaktuara si në standard. Përveç kësaj, është krijuar edhe marka e konformitetit "Kreditor i përgjegjshëm". Kjo do ta lejojë identifikimin e institucioneve financiare që janë bashkuar me Shoqatën e Inovacionit Financiar të Kosovës dhe janë të angazhuar të punojnë në përputhje me parimet e përcaktuara nga Standardi i Praktikës së Mirë.

Kryetari i Shoqatës së Inovacionit Financiar, Venhar Hana, ka thënë se meqë indus-

tria e inovacionit financiar është në fazën fillestare, tanimë është thelbësore që të bien dakord për zbatimin e praktikave më të mira. "Kreditë nga institucionet financiare jobankare si shumë produkte të tjera financiare të nxitura nga teknologjia janë të reja për konsumatorët. Meqë vetë industria është në fazën e saj fillestare të zhvillimit, është thelbësore që të bien dakord menjëherë për zbatimin e praktikave të mira e të përgjegjshme të biznesit që do të bënte që të dyja funksionet: ta mbrojnë konsumatorin dhe të lejojnë industrinë të zhvillohet. Për më tepër, një tjetër detyrë thelbësore e Shoqatës do të jetë ta fillojë punën me ligjvënësin dhe autoritetet mbikëqyrëse në hartimin e një strategjie afatmesme të zhvillimit të industrisë", u shpreh Hana.

Sipas tij, Standardi i Praktikës së Mirë synon të sigurojë një nivel më të lartë mbrojtjeje dhe rregulla të bashkëpunimit me klientët që kanë marrë një hua apo një shërbim tjetër financiar, ose këtë planifikojnë ta bëjnë ndonjëri prej anëtarëve të Shoqatës. "Standardi merret me pyetje të

tilla si vlerësimi i aftësisë paguese të klientit, praktika etike e marketingut, procedura e shpejtë dhe e përshtatshme e shqyrtimit të ankesave dhe pagesa e detyrimit. Për ta siguruar zbatimin e normave të përcaktuara në standard, anëtarët e Shoqatës do të ofrojnë trajnime specifike për stafin e tyre", ka thënë ai.

Hana inkurajon kredidhënësit jobankarë dhe institucionet e tjera financiare jobankare që të bashkohen me shoqatën për të punuar së bashku për një zhvillim të balancuar të industrisë. "Ne e konsiderojmë shoqatën si

një iniciativë vetërregullative për zhvillim të qëndrueshëm, implementimin e inovacioneve dhe gjithashtu një nxitje për përmirësimin e transparencës së përgjithshme të industrisë jo vetëm për IFJB-të, por për të gjithë industrinë financiare duke përfshirë sektorin bankar në Kosovë", u shpreh ai.

Sipas Venhar Hanës, misioni i Shoqatës është të promovojë praktika të besueshme, të përgjegjshme sociale dhe të qëndrueshme të huadhënies të cilat vlerësohen pozitivisht nga konsumatorët dhe autoritetet mbikëqyrëse. "Në të njëjtën

kohë, shoqata do të punojë për t'i promovuar mundësitë e ofrura nga zgjidhjet e teknologjisë financiare jobankare që përfitojnë individët dhe shoqëria në tërësi", ka thënë Hana, duke shtuar se misioni i shoqatës së tyre është të promovojë praktika të besueshme të cilat vlerësohen pozitivisht nga konsumatorët dhe autoritetet mbikëqyrëse. "Në të njëjtën kohë, shoqata do të punojë për t'i promovuar mundësitë e ofrura nga zgjidhjet e teknologjisë financiare jobankare që përfitojnë individët dhe shoqëria në tërësi", ka thënë Venhar Hana.

## Nga taksa 100 për qind, Serbia humbi rreth 300 milionë euro

**PRISHTINË, 23 MAJ** - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) nga data 15 prill e deri 15 maj 2019 ka realizuar një studim hulumtues në 250 kompani të zgjedhura në industrinë ushqimore tregtare, shërbuese dhe të ndërtimitarisë me 250 konsumatorë të Kosovës për të arritur deri në një rezultat se në çfarë mase kanë ndikuar vendimet e taksës 100 për qind për produktet ndaj Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se Kosova nga taksa ka përfituar shumë si në aspektin ekonomik, diplomatik, politik dhe negociues. "AKB-ja e vlerëson taksën 100 për qind si betejë ekonomike, politike dhe diplomatike kundër Serbisë. Taksa ndaloi hovin e negociimit për ndarjen apo korrigjimin e kufijve të Kosovës dhe kjo u vërtetua në Samitin e Berlinit. Periudha gjashtëmujore nga vendosja e tak-

sës ka rezultuar që Serbia humbi rreth 300 milionë euro sipas deklarimeve të institucioneve serbe, por sipas deklarimeve nga Dogana e Kosovës që krahason një vit më herët me këtë gjashtëmujor Serbia ka humbur mbi 230 milionë euro", ka thënë Shahini. Ai ka thënë se taksa ka ndikuar edhe në rritjen e punësimit. "Rreth 55 për qind e bizneseve kanë deklaruar se ka pasur ndikim pozitiv taksa e cila ka rritur industrinë ndërtimore rreth 40 për qind, sektorin e ushqimit rreth 30 për qind, transportin 20 për qind, por në të njëjtën kohë ka pasur rritje të punësimit në gjithë sektorët e përmendur 20 për qind", ka thënë Shahini. Sipas tij, furnizimet janë orientuar nga tregjet e BE-së me rreth 40 për qind, Shqipëria dhe Maqedonia rreth 15 për qind, si dhe pjesa tjetër nga Turqia, Azia dhe vendet e tjera.



## Përkujtohen dëshmorët Fazli Jakupi e Xheladin Asllani

SKENDERAJ, 23 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me drejtorët komunalë, familjarët dhe përfaqësuesit e shoqatave të dala

nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë përkujtuar dëshmorët Fazli Jakupi në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë dhe Xheladin Asllani në

Makërmal, në nderim të 20-vjetorit të rënies së tyre për lirinë e Kosovës. Në bashkëbisedim me familjarët e heronjve, pas homazheve

kryetari Jashari ka theksuar se duhet të jemi të bashkuar, në mënyrë që të përmbushet amaneti i dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



## Ramosaj nënshkruan memorandum me Qendrën për Mirëqenien e Gruas

DEÇAN, 23 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka pritur të enjten në takim Ardita Ramizi-Bala nga Qendra për Mirëqenien e Gruas (QMG), me të cilën ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi ndërmjet dy institucioneve dhe Qendrës për Mirëqenien e Gruas Strehimore

për Viktimat e Dhunës. Qëllimi i këtij memorandum është për ta përkrahur QMG-në me mjete financiare për të ofruar shërbime të strehimit, rehabilitimit dhe riintegritimit për gra dhe fëmijë viktime të dhunës në familje të Komunës së Deçanit.

Në bazë të këtij memorandumi

Komuna e Deçanit do t'i mbulojë shpenzimet e QMG-së, strehimores bazuar në planin vjetor të strehimores. QMG-ja do t'i strehojë gratë dhe fëmijët, viktimat e dhunës në familje nga një deri në gjashtë muaj dhe do t'i marrin të gjitha shërbimet e ofruara në këshillim, rehabilitim dhe riintegritim.

## Në Prizren punohet intensivisht për qarkullimin më cilësor në të gjitha rrugët e komunës

Prizren, 23 maj (ER) - Në kuadër të projektit për rehabilitimin e rrugëve me asfalt, kanë përfunduar punimet përgjatë rrugëve "Adnan Krasniqi" dhe "Mejdani i Shkodrës" në Prizren, prapa Gjimnazit "Gjon Buzuku", ku

është bërë rehabilitimi i rrugës dhe rregullimi i kanalizimit fekal. Pas këtyre punimeve të realizuara me qëllim të përmirësimit të kushteve për qarkullim, është bërë edhe asfaltimi i rrugës në gjatësi prej 300 metrash.



## Begaj: Pa rregullimin e kanalizimit kryesor nuk mund të trajtohen ujërat e zeza



MALISHEVË, 23 MAJ (ER) - Nën organizimin e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) në Malishevë është mbajtur një takim me përfaqësues të njëmbëdhjetë fshatrave dhe kryetarit të kësaj komune, Ragip Begaj, ku është trajtuar çështja e kanalizimeve në fshatrat që shtrihen përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha dhe e kanalizimit kryesor. Në këtë takim, kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, ka deklaruar se pa rregullimin e vijës kryesore të kanalizimit dhe funksionalizimin e kësaj vije nuk mund të zgjidhet problemi i trajtimit të ujërave të zeza.

Në këtë takim përfaqësuesit e këtyre fshatrave i kanë paraqitur shqetësimet e tyre, sidomos për ndotjen e rrjedhës së

lumit, si një prej problemeve që duhet të zgjidhet shpejt, pasi vazhdimi i derdhjes së kanalizimeve në lumë do të ketë pasoja afatgjata dhe vështirë të riparueshme. "Rregullimi i sistemit të kanalizimeve është prioriteti yni dhe do të vazhdojmë të punojmë në këtë drejtim. Ajo që ne planifikojmë të bëjmë në vijim është incizimi i tërësisht të vijës së kanalizimit kryesor, gjetja dhe riparimi i defekteve dhe rregullimi në funksion i kësaj vije bashkë me ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza. Kjo është mënyra e vetme e mundshme për trajtimin e mirëfilltë të ujërave të zeza dhe mbrojtjen e lumit", ka thënë Begaj.

## Fillojnë punimet e një parku në qytetin e Suharekës

SUHAREKË, 23 MAJ (ER) - Komuna e Suharekës ka njoftuar se janë duke vazhduar projektet e ndryshme në të mirë të qytetarëve të saj. Në

qytetin e Suharekës ka filluar të ndërtohet një park për të gjithë qytetarët e kësaj komune. Për ta parë ecurinë e punimeve në këtë park ka

shkuar të enjten kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj. Ai ka thënë se si kryetar i komunës është në shërbimin e qytetarëve.

"Me sinqeritetin dhe modestinë tonë do ta dëshmojmë seriozitetin e përkushtimit për ju", ka thënë Muharremaj.



Shkrim drejtuar gazetarëve dhe atyre që merren me politikë (2)

# Qëllimi dhe mënyra e kryerjes së krimit: gjenocidi dhe masakra



Shkruan: Bardhyl  
MAHMUTI

Duke e nxjerrë në rend të parë mënyrën se si është kryer krimi (masakrimin), ne e zhvendosim në rend të dytë atë që është thelbësore: qëllimin.

Përvjetorët e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë sjellin tmerret që ka përjetuar populli shqiptar nga zbatimi i politikës së gjenocidit serb.

Miratimi i rezolutës për gjenocidin serb nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës shënon një moment të veçantë në përvjetorët e organizuar në vitin

2019.

Edhe pse ideja për miratimin e rezolutës për gjenocidin serb dhe për krijimin e një tribunali ndërkombëtar për ndëshkimin e kriminelëve të implikuar në krimet gjatë luftës në Kosovë vuri në rend të ditës nocionin gjenocid, fjala masakër mbetet termi që dominon në interpretimin e asaj që ka ndodhur në Kosovë.

Duke qenë i vetëdijshëm për domosdoshmërinë e harmonizimit të terminologjisë që përdorim, po shkruaj këtë shkrim për të sqaruar atë që i dallon këto dy nocione.

Që në fillim duhet ta përmendim se me gjenocid nënkuptohet kryerja e cilitdo nga krimet e numëruara në nenin II të Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit që kanë për qëllim ta shkatërrojë tërësisht ose pjesërisht, një grup kombë-

tar, etnik, racor ose fetar, si të tillë.

Pra, që krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë të kualifikohen si krim të gjenocidit serb, në rend të parë duhet të dëshmohet se qëllimi i vrasjeve, i dhunës seksuale dhe i dëbimit të popullsisë ka qenë shkatërrimi i tërësisht ose pjesërisht i shqiptarëve si grup kombëtar, etnik e fetar.

Të mos harrojmë se në kualifikimin e një akti si krim të gjenocidit nuk ka rëndësi mënyra si janë bërë vrasjet, dhuna seksuale dhe dëbimi i popullsisë: Vetëm qëllimi përcakton kualifikimin e krimit.

Për këtë arsye duhet shumë më shumë të fokusohemi në qëllimin e vrasjeve, dhunës seksuale dhe dëbimit të popullsisë sesa në mënyrën si janë kryer këto krime. Fatkeqësisht në hapësirën tonë politike dhe mediatike mbizotëron e kundër-

ta.

Për ilustrim po përmend shembullin e përdorimit të termit "masakër". Jo vetëm në fjalët që mbahen në rastet përkujtimore dhe në dekorin shoqëruar të këtyre tubimeve, por edhe në shkrime dhe libra kushtuar këtyre akteve gjenocidare serbe dominon fjala "masakër".

Fjala "masakër" ka origjinë gjermane (matsken/metzgern) që do të thotë kasaphane, therje kafshësh. Kjo fjalë ka gjetur shtrirje semantike edhe në rastet kur viktimat e krimeve gjymtohen dhe ky nocion ka të bëjë vetëm me mënyrën se si është kryer krimi.

Sado të dhembshme që të jenë për çdonjërin prej nesh mënyrat e vrasjeve, e dhunimeve dhe e dëbimeve, këto çështje nuk çojnë peshë për t'i kualifikuar krimet si akte të gjenocidit. Përkundrazi, duke e nxjerrë në rend të parë mënyrën se si është

kryer krimi (masakrimin), ne e zhvendosim në rend të dytë atë që është thelbësore: Qëllimin. Madje disa herë as nuk e përmendim fare!

Për këtë arsye ne duhet të harmonizojmë kualifikimet dhe të dalim me një qëndrim që dëshmohet se në zbatimin e politikës gjenocidare në Kosovë forcat e armatosura të Serbisë kanë kryer qindra akte gjenocidare në Likoshan, në Qirez, në Prekaz, në Abri, në Reçak, në Krushë të Vogël, në Krushë të Madhe, në Suharekë, në Gjakovë, në Izbicë, në Grashticë, në Mejë, në Qyshk, në Burgun e Dubravës dhe në qindra vendbanime tjera të Kosovës, gjatë të cilave u vranë dhe u masakruan civilë shqiptarë me qëllim që të shkatërrohet shqiptari si i tillë.

Vetëm në këtë mënyrë mund të nxjerrim në rend të parë atë që është e rëndësishme: Qëllimin e aktit kriminal!

## Prokuroria kërkon zgjatjen e paraburgimit për gratë e kthyer nga Siria në Kosovë

Prishtinë, 23 maj - Prokuroria Speciale e Kosovës ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë që t'ua zgjasë paraburgimin shtëpiak grave të kthyer nga Siria. Lajmi është bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" nga avokatja e njëjës prej grave, Fehmie Gashi-Bytyçi. Ajo ka theksuar se kërkesa e Prokurorisë nuk e përcakton se edhe për sa kohë kërkohet zgjatja e kësaj mase.

Më 19 prill, 110 shtetas të Kosovës janë kthyer nga Siria në Kosovë, përfshirë 32 gra, 74 fëmijë dhe 4 luftëtarë, që morën pjesë në grupin militant Shteti Islamik. Luftëtarët janë arrestuar menjëherë, kurse grave u është caktuar paraburgim shtëpiak në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Kthimi i tyre u bë i mundur me ndihmën e Shteteve të Bashkuara.

Para një muaji, Gjykata

Themelore në Prishtinë ua caktoi masën e arrestit shtëpiak të gjitha grave të kthyer nga Siria. Vendimi i mor për shkak të veprës penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës thuhet se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurat që nga viti 2014 e deri më 20.04.2019 kanë qenë në zonën e konfliktit në Siri dhe Irak.

Drejtori i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka thënë se në zonën e konfliktit në Siri ende mbesin rreth 30 luftëtarë, 49 gra dhe 8 fëmijë.

Në vitin 2015 institucionet e Kosovës hartuan një ligj të posaçëm, me të cilin çdo per-



son që merr pjesë në luftëra të huaja do të dënohet deri në 15 vjet burgim.

Grupi militant Shteti Islamik

muajt e fundit humbi kontrollin mbi territorin të cilin e kontrollonte dhe shumë luftëtarë u arrestuan, ndërkohë që gratë

dhe fëmijët janë duke qëndruar nëpër kampe të ndryshme pasi shtetet prej nga vijnë nuk kanë pranuar riatdhesimin e tyre.

## MAShT-i dhe World Visioni nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 23 MAJ (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MAShT), Shyqiri Bytyqi, dhe përfaqësuesja e World Vision International në Kosovë,

Eljona Elmazi, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Bytyqi ka treguar se kjo marrëveshje ka për qëllim t'i rrisë rezultatet e të nxëniet të fëmijët dhe të rin-

jtë e moshës 3 deri 18 vjeç, me fokus të veçantë gjithëpërfshirjen në arsim të fëmijëve me nevoja të veçanta, viktimat të dhunës, neglizhimit, viktimat të

trafikimit, në situatë rruge, të paregjistruar në gjendjen civile, të rikthyer nga emigracioni, si dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse brenda dhe jashtë shkollës.



**E jashtëzakonshme**

## Shtanget stafi, gruaja paguan makinën e re me 66 qese plot me monedha

Stafi i një dyqani për shitjen e makinave mbeti pa fjalë kur një kliente shkoi me 66 qese plot qindarka për të paguar. Pasi porositi një makinë të tipit "Volkswagen Passat" për 26 mijë dollarë, ajo u kthye për të paguar. Stafi i habitur u



detyrua që të ulet në tokë dhe t'i numërojë qindarkat me radhë. Sipas menaxherit Mr Jiao, 17 punëtorë kaluan tre ditë duke numëruar 66 qeset që kishin rreth 18 mijë dollarë.

**FOTO E DITES**



Një njeri shihet me biçikletë në fshatin Samroang në Kamboxhia /AP/

**E rrallë**

## Legalizohet shndërrimi i trupave të vdekur në 'dhe'

Uashingtoni është bërë shteti i parë në ShBA që ka legalizuar kompostimin njerëzor. Sipas ligjit të ri, njerëzit tani mund të zgjedhin që trupi i tyre të kthehet në dhe pas vdekjes. Procesi shihet si një alternativë ndaj djegieve apo varrimit të trupave dhe si një mundësi praktike në qytetet ku toka për



varreza është e pakët. Në fund të kompostimit, trupi i kthyer në 'dhe' iu jepet njerëzve të dashur të të vdekurit dhe ata mund ta përdorin për mbjelljen e luleve, perimeve ose pemëve.

**BARSOLETA E DITËS**



**Gruaja:** Pse po gënjen, ti ishe duke shkuar 70 km/h.  
**Burri:** Moj ti, mos fol!  
**Polici:** Po ju s'keni vënë as rripin e sigurisë.  
**Burri:** Por unë e hoqa tani, pasi më ndalua ju.  
**Gruaja:** Prapë po gënjen, rripin nuk e kishe.  
**Burri:** Mbylle gojën bre!  
**Polici:** Gjithmonë me nerva është kështu?  
**Gruaja:** Jo jo, vetëm kur është i dehur.




**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjate vikendit ne ora 14:00**

**"DUMBO" 3D**

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

**Rolet:** Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.  
**Regjia:** Tim Burton



**Ne ora 16:00 dhe 19:00**

**"AVENGERS; Endgame"**

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.  
**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo



**Në ora 20:00**

**"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"**

Krim/Mister; 1 ore 48 min

**Rolet:** Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.  
**Regjia:** Joe Berlinger



**16.05.2019**

**"THE HUSTLE"**

Komedi

**Rolet:** Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

**Regjia:** Chris Addison



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Do t'ju duhet të kaloni shumë orë në ambientin e punës sot për t'i mbyllur ato gjëra që i keni lënë pezull deri në çastin që do ta merrnit miratimin.</p>	 <p><b>DEMI</b> Do të irritoheni nga sjellja e një personi të caktuar sot. Edhe pse ka shumë situata që duhet të sqarohen, nuk mund të vendosin të tjerët për punët tuaja.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> T'i impononi sjelljet tuaja te te tjerët nuk është gjëja më e mirë që mund të bëni sot. Do të krijohen çarje të mëdha në komunikimin me partnerin.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Nëse sot do të vini në plan të parë familjen, asnjë nuk do t'ju vë faj, por do të marrë si shembull sjelljen dhe përkushtimin tuaj.</p>	 <p><b>LUANI</b> Pas fazave disi të zhurmshme të jetës suaj dhe të kaluara në rrëmuje të plotë, ka ardhur momenti të ktheheni me këmbë në tokë.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Po kërkonti një udhërrëfyes sot dhe doni t'i besoni çdo gjë që ka të bëjë me punën tuaj. Nuk do ta gjeni personin e duhur, por do ta kuptoni vonë këtë gjë.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Nuk mund t'i kombinoni gjithmonë impenjimet e punës dhe ato personale. Shumë herë duhet të zgjidhni ato që kanë më tepër rëndësi për ju.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Sot duhet ta kapni momentin për të thënë atë që po e mendoni prej kohësh. Nëse ky çast ikën nuk do t'ju jepet një mundësi e dytë.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Ta rifitoni besimin e një personi që e ka humbur do të jetë qëllimi i ditës suaj sot. Do t'ju duhet shumë mund për t'i rivendosur marrëdhëniet.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Sot duhet të jeni të sigurt në vetvete dhe imunë nga kritikata që mund t'ju vijnë nga ambiente të ndryshme.</p>	 <p><b>UJORI</b> Lejoni që një person i caktuar t'ju tregojë mënyrën për të realizuar një projekt tuajin. Më vonë do të kuptoni se sa shumë interesohet për ju.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot nuk duhet të akumuloni energji negative që mund t'ju shtyjnë të merrni vendime të gabuara. Qëndroni indiferent me kolegët.</p>

## Lady Gaga realizon ëndrrën, do të performojë në teatrin "Apollo"



**K**ëngëtarja e njohur botërore Lady Gaga do të performojë për herë të parë të hënën në Teatrin Apollo të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për dy kompanitë e mëdha "SiriusXM" dhe "Pandora". Gaga ka thënë se kjo ka qenë ëndrra e saj e kamotshme që të

performojë në atë skenë. "Të performoj në Apollo ka qenë gjithnjë ëndrra ime. Faleminderit 'SiriusXM' dhe 'Pandora' që më ftuat. Jam shumë e emocionuar për fansat e mi që do të shohin një mbrëmje të veçantë", ka thënë Gaga, raporton "People".

## Zoe dhe Karl martohen fshehurazi



**Z**oe Kravitz dhe Karl Glusman thuhet se janë martuar. 30-vjeçarja dhe aktori 31-vjeçar u kurorëzuan në heshtje të mërkurën, sipas "Us Weekly". Thuhet se çifti po

planifikon një ceremoni martesore tradicionale në qershor në Francë, por tashmë janë martuar ligjërisht. Zoe dhe Karl filluan lidhjen në vitin 2016.



## Rihanna në Paris për linjën e saj "Fenty"

**S**igurisht e mbani mend këngën e saj të famshme "Man Down". Rihanna, përpos që ka lënë shumë gjurmë në muzikë, duket se gjurmë do të lë edhe në modë. Ajo është parë

në Paris, ndërsa zgjeron linjën e saj "Fenty". Pas vizitës në dyqanin e saj, Rihanna ka darkuar në njërin nga restorantet e Parisit dhe shkëlqente në të bardha.

## Transformimi i Drake ndër vite



**D**rake mund të jetë një nga reperët më të njohur në botë, por nuk ishte gjithmonë

kështu. Për Aubrey Graham ishte një udhëtim i gjatë për të qenë Drake të cilin miliona njerëz e adhurojnë sot.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**

TEL: 045 82 82 82

## Feronikeli kërkon edhe Kupën

KF Feronikeli po kërkon triumfin edhe në garën e Digitalb Kupës së Kosovës në futboll. Në anën tjetër Trepça '89 do ta kërkojë mbijetesën nëpërmjet barazhit, por synim i saj është triumfi në garën e Kupës dhe dalja në garat ndërkombëtare. "Normalisht se synimi ynë është që pas titullit të fitojmë edhe Kupën, ani pse një gjë e tillë do të jetë shumë e vështirë për faktin se Trepça '89 ka një skuadër shumë të mirë. Ata kanë pasur disa probleme në kampionat, por në Kupë janë paraqitur mirë dhe, për këtë fakt, gjenden në finale. Megjithatë, ne do ta japim maksimumin që edhe kupa të vijë në Drenas. Ndërsa për këtë ndeshje nuk kemi asnjë mungesë", ka thënë Dabiqaj



cila zhvillohet sonte (e premte) nga ora 24:45 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Dabiqaj e vlerëson maksimalisht 89-shin, por beson se Feronikeli do të dalë triumfues. "Normalisht se synimi ynë është që pas titullit ta fitojmë edhe Kupën, ani pse një gjë e tillë do të jetë shumë e vështirë për faktin se Trepça '89 ka një skuadër shumë të mirë. Ajo ka pasur disa

probleme në kampionat, por në Kupë është paraqitur mirë dhe për këtë fakt gjendet në finale. Megjithatë, ne do ta japim maksimumin që edhe Kupa të vijë në Drenas. Ndërsa për këtë ndeshje nuk kemi asnjë mungesë", ka thënë Dabiqaj. Për ndeshjen finale foli edhe futbollisti i Trepçës '89, Hasan Hyseni. Ky i fundit ka thënë për

gazetë se klubi nga Mitrovica po synon triumfin në finale dhe ta sigurojë daljen në Evropë. "Jemi përgatitur për këtë ndeshje. Synimi ynë është ta fitojmë Kupën, pasi kjo do të na mundësonte daljen në garat evropiane", ka thënë Hyseni. Nëse skuadra e Trepçës '89 e fiton Kupën do të dalë për herë të dytë në Evropë, pasi herën e parë mori pjesë në parakualifikimet e Ligës së Kampionëve si skuadër kampione nga Kosova. Ndryshe skuadra e 89-shit drejt Prishtinës për ndeshjen finale do të vijë në mënyrë të organizuar. "Grumbullimi dhe nisja bëhet para ish-'Hotel Adriatikut' në orën 18:00. Përveç transportit, kemi në dispozicion edhe 300 bileta ku do të shpërndahen falas për të gjithë ata simpatizues të cilët duke hyrë në autobusë do të pajisen me bileta. Me përkrahjen e juaj do të festojmë së bashku për fitore", thuhet në njoftimin e Trepçës '89.

**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 23 MAJ** - KF Feronikeli të dielën e kaluar e ka festuar titullin e kampionit në Superligë, pasi në ndeshjen fundit e mposhti Prishtinën (1-0). Tash skuadra nga Drenasi po synon që ta rrëmbejë

edhe trofeun e dytë në këtë edicion garash, Kupën, dhe të mbyllë një edicion superior në futboll, e vendosur për t'i vazhduar më pas garat në arenën ndërkombëtare. Një nga lojtarët më të mirë në skuadrën e Feronikelit, Albert Dabiqaj, ka folur për "Epokën e re" për ndeshjen finale të Kupës, e

## 36 200 euro për sukseset e sportistëve

**PRISHTINË, 23 MAJ** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, të enjten ka bërë ndarjen e shpërblimeve shtetërore për sportistë dhe trajnerë. Ndarja e këtyre shpërblimeve u bë sipas dispozitave të Rregullores Nr. 15/2013 për Ndarjen e Shpërblimeve Shtetërore për Sportistët që Arrijnë Rezultate Kulminante në Garat Ndërkombëtare. Xhudistja Erza Muminović është shpërblyer me 10 mijë euro për medaljen e bronzë në xhudo në Lojërat Olimpike për të Rinj në kategorinë -44 kg, të mbajtura në Buenos Aires të Argjentinës. Ndërsa xhudisti Akil Gjakova është shpërblyer me 5 000 euro për medaljen e artë në xhudo në Kampionatin Evropian U23 në kategorinë -73 kg, të mbajtur në Gyor të Hungarisë. Sikurse Akili, edhe xhudistja Loriana Kuka është shpërblyer po me 5 000 euro për medaljen e artë në xhudo në Kampionatin Evropian U23 në kategorinë -78 kg, të mbajtur në Gyor të Hungarisë. Ndërkaq, trajner Driton Kuka



shpërblyet me 5 500 euro si trajner i xhudistes Erza Muminović dhe me 2 500 euro si trajner i sportistëve Akil Gjakova dhe Loriana Kuka. Karateisti Melos Gashi shpërblyet me 3 500 euro për medaljen e argjendtë në karate, në Kampionatin Evropian për kadet-juniorë dhe U21 të karatesë në kategorinë +70 kg, të mbajtur në Aalborg të Danimarkës. Ndërkaq trajneri i tij, Muhamet Rexhepi, shpërblyet me 1 750 euro. Karateistja Albulena Gërvalla shpërblyet me 2 000 euro për medaljen e bronzë në karate në Kampionatin Evropian për Kadet Junior dhe U21 të Karatesë në kategorinë -55 kg, të mbajtur në

Aalborg të Danimarkës. Ndërkaq trajneri i saj, Isak Curri, shpërblyet me 1 000 euro. "Është kënaqësi e veçantë për mua si ministër që në këtë ceremoni t'i ndajmë këto shpërblime dhe mbështetjen tonë financiare për sportistët dhe trajnerët më të mirë. Jemi të vetëdijshëm si Ministri që munda dhe puna juaj nuk shpaguhet me mjete financiare, megjithatë këto shpërblime janë motivim shtesë", ka thënë ministri Kujtim Gashi. "Synimi ynë është që t'i mbështesim sportistët dhe trajnerët që me punën dhe angazhimin e tyre janë duke e promovuar shtetin e Kosovës. Unë i quaj ambasadorë të Kosovës sepse tashmë jemi mësuar ta shohim flamurin të ngrihet në shumë vende të tjera, madje ata po na bëjnë krenarë edhe në vendet që nuk e njohin Kosovën. Është fat i mirë që gjatë vitit aktual kemi ngritur buxhetin për mbështetjen e sportistëve dhe të trajnerëve me një ngritje prej 120 %, sepse fokusi dhe përkushtimi jonë ka qenë që t'u dalim në mbështetje financiare

të gjithë sportistëve dhe trajnerëve po edhe të gjitha të llojeve të sporteve dhe besoj se të gjitha këto rezultate janë edhe meritë e një angazhimi tonë të përbashkët mes qeverisë, trajnerëve dhe klubeve të cilat po korrin suksese", ka deklaruar ministri Gashi. Ministri Gashi ka shtuar se "janë këta sportistë që na kanë sjellë medalje gjatë vitit 2018 dhe 2019 dhe gjithë këto rezultate kanë emrat e mbiemrat dhe një ndër ta është trajneri Driton Kuka që i ka sjellë mbi 50 medalje

Kosovës". Sportistët dhe trajnerët që morën këto shpërblime falënderuan ministrin Gashi për mbështetjen. "Viti 2018 shquhet me dy ngjarje të rëndësishme, gara në Hungari dhe Gara Olimpike për të Rinj. Prania jote ministër ka shënuar diçka të rëndësishme. Për herë të parë në lojëra olimpike Erza na ka shpërtuar fytyrën, jemi kthyer me një medalje të bronzë. Përkushtimi yt për ngritjen e kushteve dhe mundësive për sportistë është në nivel shumë të lartë", ka thënë trajneri Driton Kuka.

### Liverpooli mendon shitjen e Shaqirit

**LIVERPOOL, 23 MAJ** - Futbollisti Xherdan Shaqiri mund të largohet në verë nga skuadra e Liverpoolit pasi trajneri Jurgen Klopp nuk e sheh si të përshtatshëm për filozofinë e lojës së tij. "The Sun" raporton se "Reds" është gati ta shesë futbollistin shqiptar, gjithnjë nëse vjen ndonjë ofertë serioze për të. Liverpooli shpenzoi verën e kaluar 15 milionë euro për Shaqirin, kurse tash synon ta shesë dhjetë milionë më shumë. Shaqiri për Liverpoolin është paraqitur në 24 ndeshje dhe ka realizuar 6 gola, kurse në të kaluarën ka luajtur edhe për Interin, Bayern Munchenin dhe Baselin.



### Trajneri i Malit të Zi: Ndeshja ndaj Kosovës, e vështirë

**PODGORICË, 23 MAJ** - Trajneri i Malit të Zi, Ljubisa Tumbaković, ka folur para sfidave ndaj Kosovës dhe Çekisë. Ai pret dy ndeshje shumë të vështira, duke

ditur forcën e rivalëve. "Në qershor na presin dy ndeshje mjaft të rëndësishme, së pari me Kosovën në shtëpi, më pas në udhëtim me Republikën Çeke.

Do të mundohemi që për këto ndeshje ta përgatisim ekipin në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të zbrisin në fushë ata që janë në formën më të mirë,

për të dalë sa më mirë në këto dy ndeshje", përfundoi Tumbaković. Ndeshja Mali i Zi - Kosova zhvillohet më 7 qershor pa shikues në Podgoricë.



## Duranti, afër largimit nga Golden State

OAKLAND, 23 MAJ - Kevin Durant është pranë largimit nga skuadra kampione e Golden States, me të cilën është kualifikuar edhe këtë vit në finale të "play-off"-it. 30-vjeçari luan prej tre sezonesh me Warriorsin, por

nga 1 korriku ai do të jetë "free agent" (lojtar i lirë). Vështirë se ai do ta rinovojë kontratën me Golden State. Çka do të thotë se ai mund të largohet dhe të zgjedhë skuadrën e re. Sipas "NY Times", dy janë skuadrat që

mund ta afrojnë talentin e NBA-së: Nju Jorku dhe Clippers. Këto skuadra kanë mundësitë financiare dhe hapësirën për t'i ofruar Durantit kontratën që ai dëshiron. Kevin Durant është një nga yjet e NBA-së që ka

ndihmuar Golden State ta fitojë titullin kampion në dy sezonet e fundit dhe është pranë titullit të tretë në karrierë. Ai është lojtari që do ta tërheqë vëmendjen e merkatos së verës së bashku me Kawhi Leonard (Toronto).



## IHF: Spanjës i merret kampionati nëse nuk respektohen simbolet e Kosovës

PRISHTINË, 23 MAJ - Federata Ndërkombëtare e Hendbollit (IHF) ka reaguar menjëherë pas letrës që i ka dërguar Federata e Hendbollit e Kosovës lidhur me diskriminimin gjatë ceremonisë së shortit për botërorin e juniorëve që mbahet në korrik në Spanjë. Spanjollët në ceremoninë e shortit nuk kanë shfaqur flamurin e Kosovës, por e kanë paraqitur Kosovën me logo të FHK-së. Reagimi i Federatës sonë ishte i menjëhershëm dhe i ashpër dhe IHF-ja nuk ka qëndruar duarkryq.

Në një letër që drejtori gjeneral i IHF-së, znj. Amal Khalifa, ka dërguar të enjten në adresë të FHK-së, është bërë e qartë që Spanjës do t'i merret e drejta e organizimit të kampionatit botëror nëse nuk garanton se flamuri dhe himni i Kosovës do të shfaqen gjatë kësaj ngjarje të madhe. Autoritetet spanjolle kanë afat deri në fillim të qershorit të japin këtë garanci. Nëse kjo nuk ndodhë atëherë kampionati botëror do të mbahet



në një vend tjetër. Kështu IHF-ja i ka dalë në mbrojtje trajtimit të barabartë të të gjitha vendeve pjesëmarrëse në botëror. "Dëshirojmë t'ju informojmë se IHF-ja është në kontakt të afërt me Federatën e Hendbollit të Spanjës dhe me Komitetin Olimpik të Spanjës. IHF-ja qartë i ka komunikuar Federatës së Hendbollit të Spanjës dhe Komitetit Olimpik të Spanjës që flamuri juaj kombëtar

duhet të shfaqet dhe himni juaj kombëtar duhet të intonohet gjatë Kampionatit Botëror të Juniorëve 2019. IHF-ja ka dhënë afat deri në fillim të qershorit për organizatorin t'i sigurojë kushtet e përmendura. Në të kundërtën, Kampionati Botëror i Juniorëve do t'i jepet një federate tjetër nacionale. Natyrisht se do t'ju informojmë për të rejtat", thuhet në letrën e IHF-së.

## Zbulohen mesazhet e Salas: U interesojnë vetëm paratë, nuk dua të shkoj në Cardiff

CULULU, 23 MAJ - Vazhdon të tronditë historia e Emiliano Sala, i cili humbi jetën gjatë një udhëtimi nga Nantes në Cardiff, ku do të transferohej. Avioni i tij humbi nga radarët dhe ai u gjet në fund të detit. Rreth 3 muaj më vonë, edhe babai i tij, Horacio, humbi jetën nga një sulm në zemër. Ai akuzoi se Cardiffi e la djalin e tij të vdiste si një qen. Ka qenë prestigjiozja franceze "L'Equipe" e cila në një dokument të publikuar ka zbuluar mesazhet tronditëse që Sala i dërgonte një të afërmi të tij. Aty zbulohet se argentinasi nuk donte të transferohej. "Fola mbrëmë me agjentin, më tha që Frank Kita, i biri i presidentit Kita, i kishte thënë se duan të më shesin. Ata kanë marrë një ofertë nga Cardiffi. Kanë vendosur një çmim të lartë, megjithatë ata kanë pranuar. Është kontratë e mirë, por jo interesante për mua. Ata duan të shkoj me çdo kusht. Nuk kam frikë sepse jam mësuar me sfida gjithë



jetën time. Shpresoj që agjenti të gjejë diçka më të mirë. Nuk dua ta shoh Kitan sepse acarohem. Do që unë të shkoj në Cardiff, i interesojnë vetëm lekët, pa më pyetur se çfarë dua unë. Më duhet ta shoh

përditë surratin e tij", ishin disa nga mesazhet e dërguara nga Sala. Kujtojmë se Kita është presidenti i Nantes dhe Sala shpreh qartë dëshirën për të mos shkuar te Cardiffi.

### SHKURT

#### Mitrovica, fituese e Kupës

Skuadra e Mitrovicës është fituese e Kupës së Kosovës në konkurrencën e femrave. Në ndeshjen finale që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet, në praninë e disa qindra tifozëve, vashat e drejtuara nga Seid Onbashi kanë shënuar fitore me rezultat bindës kundër Kosovës së Prishtinës, me shifrat 7-1, duke u kurorëzuar kështu për të dytin vit rresht me këtë trofe. Serinë e golave për Mitrovicën e hapi kapitenia Xhemile Berisha në minutën e 14-t, duke vazhduar më pas Liridona Sylja (23'), Kaltrina Biçkaj (29'), para se prishinaset ta shënonin golin e parë nëpërmjet Fjona Shabanit (40'), që në fund doli të ishte edhe goli i vetëm i skuadrës së drejtuar nga Ilir Sopi. Donjeta Halilaj shënoi edhe golin e katërt për Mitrovicën para fundit të pjesës së parë. Mitrovicaset shënuan edhe tri gola në pjesën e dytë nëpërmjet kapitenes Xhemile Berisha (59') dhe dy gola të Kaltrina Biçkajt (85', 89').

#### AGI: Guardiola prezantohet te Juve më 4 qershor

"Agenzia Giornalistica Italia (AGI)" raporton se Juventusit ka arritur marrëveshje me trajnerin e Manchester City, Pep Guardiola. Guardiola do të nënshkruajë kontratë katërvjeçare dhe do të përfitojë një pagë prej 24 milionë eurosh në sezon. Sipas kësaj agjencie, Guardiola do të nënshkruajë me Juventusin më 4 qershor, kurse dhjetë ditë më vonë do të prezantohet si trajner i "Zonjës së Vjetër".

#### Williani kundër largimit të Hazardit

Anëtori i Chelseat, Willian, është kundër largimit të Eden Hazardit nga "Stamford Bridge". Futbollisti belg pritet që në afatin kalimtar të verës t'i bashkohet Real Madridit. "Është e vështirë të them ndonjë gjë për këtë situatë sepse ne nuk e dimë se çfarë do të ndodhë. Ajo që mund ta them është se nëse shkon, unë do të jem shumë i mërzitur", ka thënë Willian.

#### Lewandowski kërkon transferimin e Sanes

Ylli i Bayern Munichut, Robert Lewandowski, ka kërkuar nga drejtuesit e klubit për të transferuar Leroy Sane nga Manchester City. "Ky është një lojtar super me cilësi të mëdha dhe potencial të madh. E kam parë shumë herë se sa i mirë është ai. Është një lojtar i cili menjëherë mund të dërgojë më lart, që përmirëson ekipin", ka thënë Lewandowski.

#### Leclerc: Shpresoj të vijë 'shpërthimi' i Ferrarit

Këtë fundjavë Formula 1 do të zhvendoset në Principatën e Monacos, ku më datën 26 maj do të zhvillohet edhe gara e gjashtë sezonale, pas 5 të parave të dominuara tërësisht nga dy makinat Mercedes, me Hamilton e Bottas që kanë këmbyer vendet e para me njëri-tjetrin. Një fillim tejet i dobët për Ferrarin këtë sezon, sepse pas 5 garash, "kokëkuqja" nuk numëron asnjë triumf apo vend të dytë, ndërsa vetëm në dy raste, njëherë me Vettelin dhe një herë me Leclercin, ia ka dalë të ngjitet në podium. Pikërisht ky i fundit duket i frymëzuar këtë fundjavë, pasi gara do të zhvillohet në "shtëpinë" e tij, ndërsa në një intervistë të dhënë për mediet franceze ka theksuar se shpreson që në Çmimin e Madh të Monacos të vijë edhe shpërthimi i Ferrarit. "Kemi bërë disa teste dhe ende nuk mund të themi se i kemi afruar Mercedesit, por inxhinierët tanë po punojnë shumë për të gjetur një zgjidhje. Shpresoj shumë që gara e Monacos ta sjellë edhe 'shpërthimin' e Ferrarit, pasi është e pabesueshme që ende nuk kemi fituar në asnjë pistë", ka thënë Leclerc.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansija - Ministry of Finance*

Ministria e Financave, mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, "Për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës", dhe Rregullores nr. 02/2010, "Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil", me qëllim të realizimit të procedurave të rekrutimit për pozitën e caktuar. Shpallë këtë:

### KONKURS

#### I. Departamenti Auditimit të Brendshëm

**Titulli i pozitës:** Auditor i Brendshëm (1 pozitë)  
**Numri i referencës :** 13/2019/ DAB/MF  
**Grada e vendit punës:** Niveli profesional  
**Koeficienti:** 15

#### Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të Auditimit dhe miraton planet e punës dhe afate për bërjen e auditimeve dhe shërbimeve përkatëse;
- Kryen dhe udhëheq auditime përfshirë intervistat hyrëse në sektorin që auditohet interviston stafin, merr dhe analizon, dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat;
- Përgatit raportin, diskuton me mbikëqyrësin dhe bën intervistën përfundimtare me të audituarin
- Harton raportin final, me rekomandimet adekuate, finalizon dosjen e Auditimit dhe dorëzon at për arkivim;
- Përcjell zbatimin e rekomandimeve nga ana e institucioneve dhe njësive organizative;
- Ofron udhëzime për stafin e nivelit më të lartë të njësive të Auditimit të brendshëm për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre.
- Ofron këshilla për çështje të Auditimit brendshëm brenda institucionit sipas nevojës ;
- Koordinon punën me pjesë tjerë të institucionit dhe komunikon me autoritet e jashtme sipas nevojës
- Të vlerësoj sistemet kontrollit të brendshëm të dizajnuara nga menaxhmenti i lart se a janë adekuate.

#### Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në ekonomi, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo Juridik;
- Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e Auditimeve;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathësi kompjuterikë në programet kompjuterike Windows, Word, Excel dhe Acces.
  - Kriteret specifike për Auditor të brendshëm janë:
- Të ketë kryer me sukses trajnim rigoroz profesional dhe testimin për auditor të brendshëm;
- Të jetë i certifikuar si auditor i brendshëm;
- Të zhvilloj vazhdimisht njohurit , aftësitë profesionale për të ruajtur licencën për auditor të brendshëm dhe ruajtjen e licencimit duke marr pjesë në trajnime në minimum 30 orë brenda vitit si dhe të ruajnë certifikimi e tyre profesional në fusha të ndryshme të sistemit të kontrollit të brendshëm si : auditim të brendshëm , kontabilitet , financa menaxhim në sektorin publik, teknologji informative , prokurim publik etj.

#### INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Ministria e Financave ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, Dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), letërnjoftimin, Dëshminë e përvojës së punës dhe dy referenca. Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (ruga Nëna Terezë p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen : <http://www.mf-rks.org/> ;

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Divizionin e burimeve njerëzore, Ndërtesa e Qeverisë, kati i XII, zyra nr. 1207.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e emërimit sipas LSIIC, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1 vjeçare.

**Afati i konkurrimit është prej datës 24/05/2019 deri me datë 07/06/2019, deri në orën 16:00.**

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038/200/34/196; 038 200 34 155.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Kosova Cumhuriyeti  
Republic Of Kosovo



**Komuna e Prizrenit**  
Opština Prizren-Prizren Belediyesi  
Municipality Of Prizren

#### DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

DATE:	
REFERENCË:	Zyrtar
NGA:	Drejtoria e Shërbimeve Publike – Prizren
TEMA:	Shpallje

Në bazë të vendimit të kryetarit të komunës nr.01/060-52095 dhe në bazë të rregullores nr. 01/011-30-2006, neni 27, neni 37 dhe neni 38, dhe në bazë të ligjit mbi sigurinë në komunikacion rrugorë nr. 02/L-70 dhe Neni 2, Pika 2.3, dhe Pika 2.7.

Drejtoria e Shërbimeve Publike;

### SHPALLJE

#### Për shërbimin e transportit me mjete bartëse (Merimangë)

Njoftohen të gjitha ndërmarrjet e interesuar që të konkurrojnë për shërbimin e transportit me mjete bartëse në Komunën e Prizrenit.

Kërkojnë këto dokumente:

- Certifikata e biznesit (fotokopje e vërtetuar bashkë me shtojcën Informata e biznesit),
- Letërnjoftimin e prararit të ndërmarrjes (fotokopje),
- Të ketë së paku 3(tre) automjete bartëse minimum njëri të jetë me kran dhe të jenë në gjendje të rregullt teknike(të dëshmuar dhe me foto),
- Të ketë së paku 16 bllokues rrotash ngjyrë të Verdhë, të dëshmuar dhe me foto
- Të ketë pajisje për komunikim (lidhje telefonike seli),
- Selia e ndërmarrjes të jetë në Komunën e Prizrenit,
- Vend parkimi për ruajtjen e automjeteve të jetë me listë poseduese ose me kontratë e noterizuar dhe të ketë hapësirë të mjaftueshme po ashtu të jetë e rrethuar për sigurinë e automjeteve.
- Të ketë Dy shofer me kategori C dhe një me të gjitha kategoritë dhe dy punëtorë ndihmës (punëtorët të jenë të regjistruar në listën e punëtorëve në ATK-së paku 3(tre) muajt e fundit),
- Automjeti të jetë i Regjistruar dhe i siguruar në emër të ndërmarrjes, të jetë i dedikuar posaçërisht për këtë lloj transporti dhe të ketë mekanizëm adekuat për ngarkim – Shkarkim të Automjeteve,
- Të ketë dritën rrotative mbi pjesën e sipërme të automjetit e cila duhet të funksionoj gjatë ushtrimit të veprimtarisë,
- Minimum 1 (një)Referencë për Ushtrimin e veprimtarisë të kësaj natyrës, 2(dy) vitet e fundit,
- Të ketë të dëshmuar përvojën e punës minimum 3 vite, (të dëshmuar me kontrata),
- Qarkullimin bankar minimum 40.000,00€, dy vitet e fundit,
- Librezave të qarkullimit të auto bartjeve,
- Vërtetimi Gjykatës ekonomike për biznes,
- Vërtetimi i tatimit në Pronë,
- Vërtetimi i mbeturinave.

#### P. S. të gjitha dokumentet e lartcekura duhet të jenë original ose të vërtetuara.

Aplikacionet si dhe udhëzimet në lidhje me tenderin mund të merren në zyrën e prokurimit në objektin e KK Prizrenit prej 24. 05. 2019 deri me 11. 06. 2019

Dorëzimi i ofertave bëhet deri me 11. 06. 2019 ora 13.30 në sportelin nr.2.

Hapja e ofertave bëhet me 11. 06. 2019 ora 14.00. në zyrën e prokurimit.

Të dhënat për ofertuesit

Emri dhe mbiemri i ofertuesit : \_ (OE) \_\_\_\_\_

Nr.letrenjofimit \_\_\_\_\_

Nr. Telefonit \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Ofertimi do të bëhet me zarfa të mbyllura.

Na osnovu odluke gradonačelnika broj 01 / 060-52095 i na osnovu Uredbe br. 01 / 011-30-2006, član 27, član 37 i član 38, au skladu sa Zakonom o bezbednosti u drumskom saobraćaju br. 02 / L-70 i član 2, odeljak 2.3, i tačka 2.7. Direkcija javnih službi;

NAJAVA Za usluge transporta tereta (Spider)

Sve zainteresovane kompanije su obavestene da se takmiče za uslugu prevoza sa vozilima u opštini Prizren. Ovi dokumenti su potrebni: 1. Poslovni certifikat (fotokopija ovjerena zajedno sa dodatkom o poslovnim informacijama), 2. Lična karta vlasnika preduzeća (fotokopija), 3. Imati najmanje 3 (tri) minimalna vozila sa kranom i biti u redovnom tehničkom stanju (dokazano i na slici), 4. Imajte najmanje 16 žutih, testiranih i zaključavanja za kola sa fotografijama 5. Od ovog komunikacionog uređaja (sedište telefonske veze), 6. Sedište preduzeća je u opštini Prizren, \ t 7. Parkirno mjesto za skladištenje vozila mora biti iz posjedovne liste ili ovjerenog ugovora i mora postojati dovoljno prostora koji će biti priložen za sigurnost vozila. 8. Imati dva vozača kategorije C i jedan sa svim kategorijama i dva pomoćna radnika (radnici moraju biti registrovani u PAK-ovoj listi zaposlenih najmanje 3 (tri) meseca), 9. Vozilo mora biti registrovano i osigurano u ime preduzeća, posebno namenjeno za ovu vrstu prevoza i imati odgovarajući mehanizam za utovar - ispuštanje vozila, 10. Imaju rotirajuće svetlo na gornjem delu vozila koje treba da funkcioniše tokom obavljanja aktivnosti, 11. Najmanje 1 (jedan) Referenca za obavljanje aktivnosti ove prirode, poslednje 2 (dve) godine, 12. Imati dokaz o radnom iskustvu od najmanje 3 godine (dokazano ugovorom) 13. Promet banke najmanje 40.000,00 €, poslednje dvije godine, 14. Knjižice za transfer vozila, 15. Potvrda Privrednog suda za privredu, 16. Dokaz poreza na imovinu, 17. Sertifikacija otpada. P. S. Svi gore navedeni dokumenti moraju biti originalni ili ovjereni. Prijave kao i uputstva u vezi sa tenderom mogu se uzeti u kancelariji nabavke u prostorijama MA Prizren od 24. maja 2019. do 11. juna 2019. godine. Podnošenje ponuda se vrši do 11. 06. 2019 u 13.30 sati na šalteru br. Ponuda će se izvršiti 11. 06. 2019. u 14.00 sati u kancelariji nabavke. Podaci za ponuđače Ime i prezime ponuđača: \_ (EO) \_\_\_\_\_ Broj obavještenja \_\_\_\_\_

Br. Telefon \_\_\_\_\_ Adresa \_\_\_\_\_

Ponuda će se vršiti sa zatvorenim kovertama.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government



Këshilli i Sigurisë i Kosovës  
Savet Bezbednosti Kosova / Kosovo Security Council  
Sekretariati / Sekretariat / Secretariat

Na osnovu člana 12. stav 4. Zakona br. 03 / L -149 o civilnoj službi Republike Kosova, i Zakon br. 04 / L-077 o obligacionim odnosima, Sekretarijat Saveta Bezbednosti Kosova donosi:

### Najava Javnog Konkursa za Sporazum o Specijalnim Uslugama

Ime Institucije	Sekretariat Saveta Bezbednosti Kosova
Organizaciona Jedinica	Direktorat za Sigurnosne Analize i Politike
Naslov rada:	Stručnjak za bezbednost
Broj referencije	01/2019/DSAP/SSBK
Nivo plate:	Za pregovaranje
Izvestava kod:	Direktora Direktorata za Sigurnosne Analize i Politike
Vrsta ugovora:	Sporazum o posebnim uslugama - (SPU)
Trajanje ugovora:	Šest (6) meseci
Radno vreme:	Puno vreme
Broj rukovodilaca:	Jedan (1)
Mesto:	Pristina

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Analizirati razvoj i implementaciju svih relevantnih dokumenata politike, i politike Kosovske sigurnosne strategije;
- Razviti / uciniti stratešku analizu kao kompleksan analitički proizvod koji traži veze, razloge i posledice u važnim oblastima sigurnosti, te donosi zaključke i daje preporuke u vezi s ostvarivanjem najavljenih ciljeva;
- Analizirati preko Direktora DSAP-a i pružiti pravna i politička mišljenja i savete sekretaru SBK-a u razmatranju strategija, nacrtu zakona i međunarodnih sporazuma, kao i svih materijala i dokumenata koje je Savet Bezbednosti Kosova podneo po zakonu i zahteva da se razvijaju ili revidiraju;
- Službenik sprovodi istraživanja o temama koje utiču na nacionalnu, regionalnu i međunarodnu bezbednosnu oblast i odgovoran je za uskladjivanje zakona i strateških dokumenata;
- Razvija i održava kontakte na relevantnom nivou sa vladinim institucijama i drugim sigurnosnim organizacijama za razmjenu informacija i predstavljanje stavova sektora o relevantnim pitanjima;
- Sažeti izvještaje o radu i finalizirati primarne i sekundarne analize o pitanjima vezanim za sigurnost, koje se slijede od stručnih osoba;
- Obavlja druge funkcionalne odgovornosti koje, u skladu sa važećim zakonima i propisima, koja se mogu zahtijevati od direktora DSAP-a i Sekretara SBK-a kako bi osigurali postizanje ciljeva.

#### Kvalifikacija, radno iskustvo i vještine:

- Diploma Univerziteta;
- Znanje i iskustvo u oblasti bezbednosnih politika;
- Visoka sposobnost pismenog izvještavanja;
- Veštine komunikacije, planiranja rada i timske saradnje;
- Sposobnost rada u timu i pod pritiskom.

#### Uslovi učešća u konkursu:

Pravo na konkurs imaju svi državljani Republike Kosova odraslog doba koji imaju punu sposobnost da deluju, imaju građanska i politička prava, imaju neophodno obrazovanje i stručnu sposobnost da obavljaju dužnosti i koji imaju veštine i fizička svojstva koja su potrebna za određenu poziciju.

#### Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zapošljavanje:

Izbor se vrši u skladu sa članom 12 stav 4 Zakona br. 03 / L-149 Civilne Službe Republike Kosova, Zakon br. 04/L-077 o obligacionim odnosima. Na ovom konkursu sprovodi se pojednostavljena procedura zapošljavanja.

**Procedure konkursa:** Procedura konkursa je otvorena za vanjske kandidate. Formular za prijavu možete naći na veb stranici: [www.ksk.rks-gov.net](http://www.ksk.rks-gov.net)

**Podnošenje zahteva:** Prijave se mogu podneti Kancelariji Sekretarijatu Saveta Bezbednosti Kosova, Zgrada Vlade, sprat -2 (minus dva).

Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja, od datuma 24.05.2019 do 31.05.2019.

Podnesci poštanskih pošiljaka, koji nose poštanski žig na pošiljci posljednjeg dana roka za podnošenje zahtjeva, smatrat će se važećim ako dođu u roku od 2 dana. Prijave koje stignu nakon ovog roka i neadekvatne prijave se odbijaju.

Uz zahtjev se prilažu i kopije dokumentacije za kvalifikaciju, iskustvo i drugu potrebnu dokumentaciju koju zahtijeva radno mjesto na kojem se konkurise.

Dodatne informacije možete dobiti na telefon: 038 200 15 607.

Samo odabrani kandidati će biti kontaktirani koji su u užem izboru.

Sekretarijat Saveta Bezbednosti Kosova podržava prijave svih muškaraca i žena iz svih zajednica.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government



Këshilli i Sigurisë i Kosovës  
Savet Bezbednosti Kosova / Kosovo Security Council  
Sekretariati / Sekretariat / Secretariat

Na osnovu člana 12. stav 4. Zakona br. 03 / L -149 o civilnoj službi Republike Kosova, i Zakon br. 04 / L-077 o obligacionim odnosima, Sekretarijat Saveta Bezbednosti Kosova donosi:

### Najava Javnog Konkursa za Sporazum o Specijalnim Uslugama

Ime Institucije	Sekretariat Saveta Bezbednosti Kosova
Organizaciona Jedinica	Direktorat za Sigurnosne Analize i Politike
Naslov rada:	Stručnjak za bezbednost
Broj referencije	01/2019/DSAP/SSBK
Nivo plate:	Za pregovaranje
Izvestava kod:	Direktora Direktorata za Sigurnosne Analize i Politike
Vrsta ugovora:	Sporazum o posebnim uslugama - (SPU)
Trajanje ugovora:	Šest (6) meseci
Radno vreme:	Puno vreme
Broj rukovodilaca:	Jedan (1)
Mesto:	Pristina

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Analizirati razvoj i implementaciju svih relevantnih dokumenata politike, i politike Kosovske sigurnosne strategije;
- Razviti / uciniti stratešku analizu kao kompleksan analitički proizvod koji traži veze, razloge i posledice u važnim oblastima sigurnosti, te donosi zaključke i daje preporuke u vezi s ostvarivanjem najavljenih ciljeva;
- Analizirati preko Direktora DSAP-a i pružiti pravna i politička mišljenja i savete sekretaru SBK-a u razmatranju strategija, nacrtu zakona i međunarodnih sporazuma, kao i svih materijala i dokumenata koje je Savet Bezbednosti Kosova podneo po zakonu i zahteva da se razvijaju ili revidiraju;
- Službenik sprovodi istraživanja o temama koje utiču na nacionalnu, regionalnu i međunarodnu bezbednosnu oblast i odgovoran je za uskladjivanje zakona i strateških dokumenata;
- Razvija i održava kontakte na relevantnom nivou sa vladinim institucijama i drugim sigurnosnim organizacijama za razmjenu informacija i predstavljanje stavova sektora o relevantnim pitanjima;
- Sažeti izvještaje o radu i finalizirati primarne i sekundarne analize o pitanjima vezanim za sigurnost, koje se slijede od stručnih osoba;
- Obavlja druge funkcionalne odgovornosti koje, u skladu sa važećim zakonima i propisima, koja se mogu zahtijevati od direktora DSAP-a i Sekretara SBK-a kako bi osigurali postizanje ciljeva.

#### Kvalifikacija, radno iskustvo i vještine:

- Diploma Univerziteta;
- Znanje i iskustvo u oblasti bezbednosnih politika;
- Visoka sposobnost pismenog izvještavanja;
- Veštine komunikacije, planiranja rada i timske saradnje;
- Sposobnost rada u timu i pod pritiskom.

#### Uslovi učešća u konkursu:

Pravo na konkurs imaju svi državljani Republike Kosova odraslog doba koji imaju punu sposobnost da deluju, imaju građanska i politička prava, imaju neophodno obrazovanje i stručnu sposobnost da obavljaju dužnosti i koji imaju veštine i fizička svojstva koja su potrebna za određenu poziciju.

#### Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zapošljavanje:

Izbor se vrši u skladu sa članom 12 stav 4 Zakona br. 03 / L-149 Civilne Službe Republike Kosova, Zakon br. 04/L-077 o obligacionim odnosima. Na ovom konkursu sprovodi se pojednostavljena procedura zapošljavanja.

**Procedure konkursa:** Procedura konkursa je otvorena za vanjske kandidate. Formular za prijavu možete naći na veb stranici: [www.ksk.rks-gov.net](http://www.ksk.rks-gov.net)

**Podnošenje zahteva:** Prijave se mogu podneti Kancelariji Sekretarijatu Saveta Bezbednosti Kosova, Zgrada Vlade, sprat -2 (minus dva).

Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja, od datuma 24.05.2019 do 31.05.2019.

Podnesci poštanskih pošiljaka, koji nose poštanski žig na pošiljci posljednjeg dana roka za podnošenje zahtjeva, smatrat će se važećim ako dođu u roku od 2 dana. Prijave koje stignu nakon ovog roka i neadekvatne prijave se odbijaju.

Uz zahtjev se prilažu i kopije dokumentacije za kvalifikaciju, iskustvo i drugu potrebnu dokumentaciju koju zahtijeva radno mjesto na kojem se konkurise.

Dodatne informacije možete dobiti na telefon: 038 200 15 607.

Samo odabrani kandidati će biti kontaktirani koji su u užem izboru.

Sekretarijat Saveta Bezbednosti Kosova podržava prijave svih muškaraca i žena iz svih zajednica.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo*  
*Agency of Statistics*

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës shpallë:

## KONKURS

### 1. Departamenti i Metodologjisë dhe TI-së një (1) pozitë të karrierës:

**Titulli:** Titulli: Një (1) Zhvillues dhe Administrator i Lartë i Sistemeve Softuerike

**Numri i referencës:** ASK-DMTI-se -001

**Koeficienti:** 8

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Zhvillon dhe implementon aplikacionet e reja, sistemet softuerike - programet, dhe/ose përmirësimin e aplikacioneve ekzistuese në kuadër të ASK-së;
- Sigurohet që aplikacionet e zhvilluara përmbushin kërkesat dhe objektivat e ASK-së, të përmbushë kërkesat e shfrytëzuesve të fundit, identifikon dhe zgjidh problemet/çështjet e sistemeve;
- Siguron dizajnin, implementimin dhe testimin e softuerit të zhvilluar, përcjellë praktikën dhe standardet e softuerit në bazë të kërkesave të punës në ASK;
- Merr pjesë aktive në fazat para-testuese të zhvillimit duke vlerësuar propozimet me qëllim të identifikimit të fushave potenciale për probleme dhe bën rekomandimet e duhura;
- Planifikon, ekzekuton dhe menaxhon integrimin e aplikacioneve të reja në sistemet ekzistuese dhe softuerëve në kuadër të ASK-së;
- Koordinon punën me administratorët të rrjetit dhe me administratorët të bazës së të dhënave, të sigurojë funksionim të plotë të infrastrukturës dhe për të asistuar në sigurimin e kualitetit/cilësisë, logjikën e programeve dhe procesimin e të dhënave;
